



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor “ Mësuesi për Arsimin Parashkollor”  
“Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asc.Dr. Dilina BESHIRI

2. Dr. Matilda LIKAJ

MAJ 2024

**Tabela përmbledhëse për programin e Ciklit të Parë,**

**Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"**

|    |  |   |
|----|--|---|
| 1  | IAL aplikues:  | Universiteti "Eqerem Çabej"<br>Gjirokastrë  |
| 2  | Njësia bazë që e ofron:                                      | Departamenti i Edukimit dhe<br>Metodologjisë së Mësimdhënies.                         |
| 3  | Emërtimi i programit të studimit:                            | Bachelor në "Mësuesi për<br>Arsimin Parashkollor"                                     |
| 4  | Urdhëri/VKM i licencimit:                                    | UAMSH;231 date 22.07.2009   |
| 5  | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                                 | -   |
| 6  | Forma e regjistrimit të diplomës:                            | UMASh nr. 334 date 13.07.2011   |
| 7  | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:                           | Akreditohet për herë të parë  |
| 8  | Cikli i studimit:  | Cikël i Parë, Bachelor  |
| 9  | Kohëzgjatja e programit të studimit:                         | 3 (tre) vite  |
| 10 | Kreditet në total (ECTS):                                    | 180 kredite ECTS  |
| 11 | Forma e studimit:  | Me kohë të plotë  |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër):  | Shqip   |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me<br>institucione të tjera: | -   |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                      | -   |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                        | -   |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:               | Niveli 6  |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e<br>studimit:          | 18 PAE v.a. 2020-2021<br>22PAE/ 3PAK v.a. 2021-2022<br>21 PAE/2PAK v.a. 2022-2023     |
| 18 | Numri i studentëve:  | 7 Studentë v.a. 2020-2021<br>17 Studentë v.a. 2021-2022<br>16 Studentë v.a. 2022-2023 |
| 19 | Komente / të tjera:  | -   |

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës**

Programi i studimit i Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, përbëhet nga 3 fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
2. Fakulteti i Ekonomisë;
3. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;

Në vitin akademik 1996-1997 në Fakultetin e përgatitjes së mësuesve të Ciklit të Ulët, për herë të parë u hap dega e Arsimin Parashkollor (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme).

Bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 823, datë 05.12.2007, krijohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

Ministria e Arsimin dhe Shkencës me Urdhër nr.231, datë 22.07.2009 urdhëron regjistrimin e formës së diplomës të Nivelit të parë (DNP) të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në Mësuesi për Arsimin Parashkollor.

Aktualisht, programi i studimit, mundëson 'Diploma Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS), gjithësej 180 kredite (ECTS), me kohë të plotë. 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh. Programi është hartuar në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi, Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimin të lartë në Republikën e Shqipërisë, datë 22.07.2015., VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimin të Larta", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018", VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018" etj., Statutin e Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe rregulloret institucionale.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, dokumentacionin shoqëruar të raportit dhe në vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 20-21.11.2023. Po ashtu, grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" nën vlerësim, me anëtarët e departamentit, përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale, si të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, Bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar dhe monitoruar nga koordinatori teknik i ASCAL-it, i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ-ja gjatë vizitës në institucion.

Më datë 20/05/2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 85/16 Prot. datë 20/05/2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti ktheu përgjigje përmes AMS, më datë 27/05/2024, me shkresë zyrtare Nr. 796/1Prot., datë 27/05/2024. Komente nuk ka, Drafti kalon ne Raport perfundimtar.



**Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

| <b>Standardi I.1</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b> | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.   | <p>Bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, programi i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por është një vlerë e shtuar në tregun e punës si një mudësi akademike në përgatitjen e mësuesve të rinjë për arsimin parauniversitar, specifíkisht në arsimin parashkollor. Programi ka miratimin e ministrisë përgjegjëse dhe ofron zhvillimin akademik në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit.</p> <p>Nevojat në rritje të tregut të punës kanë sjellë si nevojë imediate hartimin e një programi që mbartë histori akademike më të herëshme ne Shqipëri, për të arsimuar profesionistë dhe specialistë të kualifikuar për të shërbyer cilësisht në sektorin e edukimit.</p> <p>Në Statutin e Universitetit ‘Eqerem Çabej’ Gjirokastër, qartësohet se ‘Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastër ofron programe studimi në përputhje me standardet akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushatë ndryshme, me qëllim që të përgatisë profesionistë të këtyre fushave dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha<sup>1</sup>.</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin “Eqerem Çabej” Gjirokastër, mbart traditën, historinë jo vetëm të një qyteti, por të një vendi, dhe është pikërisht kjo përgjegjësi në raport me brezat dhe me kohën që bën që sfidat bazuar në ambicie të jenë dhe më të mëdha, dhe konkurrenca e zhvillimit më e fortë.</p> <p>‘Programi i studimit synon jo vetëm të çojë përpara zhvillimin e traditës së Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastër në fushat e mësuesisë por edhe t’u sigurojë studentëve aftësi akademike, kulturore dhe etike të nevojshme që mund t’i ndihmojë ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në shërbim të zhvillimit rajonal dhe kombëtar<sup>2</sup>.</p> |

<sup>1</sup> Evidenca I.1.Statuti i Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastër, Neni.63, pika 7

<sup>2</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022., Neni. 1, Neni. 2, Neni.3

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>                              | <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL-ja, Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër ka për mision të përgatisë studentët si profesionistë inovatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes si dhe qytetarë të angazhuar në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, ka qëllim të ofrojë studime universitare të cikleve të ndryshme dhe në përputhje me kornizën europiane të kualifikimeve EQF dhe kornizën shqiptare të kualifikimeve KSHK, të lidhura ngushtë me praktikën dhe aplikimin për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirëinformuar. Program i studimit synon një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse duke krijuar një përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar, shërbime me vështrim ndaj insitucioneve te edukimit. Programi i studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" synon paisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierën profesionale në fushën e arsimit parashkollor si dhe aftësimin për të përballuar kërkesat e tregut të punës në fushat dhe sektorin përkatës. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë<sup>3</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion. GJV-ja konstato se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër është institucion publik i arsimit të lartë.</li> <li>2. Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, dt.12.11.1991.</li> <li>3. Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi<sup>4</sup>.</li> </ol> <p>Ky program studimi kombinon sfidën akademike me trajnimin dhe aftësitë duke i pajisur studentët me kompetencat e domosdoshme profesionale, për punësim në të ardhmen. Programi i studimit i Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", synon ndërtimin, ruajtjen, konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe një qasje zhvillimore të qëndrueshme dhe afatgjatë<sup>5</sup>.</p>   |

<sup>3</sup> Evidenca I.9. Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022., Neni. 2

<sup>4</sup> Evidenca I.1.Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër,

<sup>5</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022., Neni. 2

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" Udhezim nr. 7 date 10.06.1996; UMASH nr. 231 date 22.07.2009 ke emertimi është "Mësuesi për ciklin e ulët parashkollor" dhe UMASH nr. 334 date 13.07.2011 për regjistrimin e formës së diplomës, me emertimin "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është pjesë e Fakultetit i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ofruar prej Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies dhe është organizuar si program i ciklit të parë bachelor, në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë si dhe në kuadrin e Kornizës shqiptare të Kualifikimeve<sup>6</sup>.</p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p> | <p>Programi i studimit Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" synon pajisjen e studentëve me kompetencat e nevojshme për të qenë të aftë të përballojnë kërkesat e tregut të punës në sektorin përkatës. Programi synon plotësimin e nevojave në rritje në vend për mësues të kualifikuar në fushën e edukimit parashkollor<sup>7</sup>. Rritja e orëve mësimore javore në shkollat e arsimit parauniversitar, ndërrimi i strategjive arsimore, për arsimin parashkollor me metodika dhe mësimdhënie bashkëkohore, janë mundësi të mëdha punësimi dhe zhvillimi ekonomik lokal apo kombëtar. Ky program ka si objekt kryesor formimin e profesionistëve të aftë për të përballur sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave edukimit dhe metodologjisë së mësimdhënies.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, i cili zbatohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me synim ruajtjen e vlerave kombëtare. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|  |  |                              |                             | <p>X</p>                     |

**Standardi I.2**

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në</p> | <p>Bazuar në shqyrtimin e evidencave dhe dokumentacionin e institucionit, Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër ka hartuar dokumente, ku përcaktohet orientimi dhe zbatimin e programeve të</p> |

<sup>6</sup> Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015.

<sup>7</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025.

|   |   |
|---|---|
| <p>zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>  | <p>studimit. Sipas Strategjisë së zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, të gjitha programet e studimit në këtë institucion nxisin mendimin kritik dhe akademik, me qëllim zhvillimin e frymës së lirisë akademike, formimin e hapësirës publike universitare të karakterizuara nga debatet konstruktive dhe me përkushtim ndaj zhvillimit shkencor<sup>8</sup>. Bazuar në strategjinë e zhvillimit të programit studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, program është i harmonizuar me Statutin e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe Strategjinë e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025<sup>9</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> | <p>Bazuar në Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, programet e studimit në këtë institucion, hartohen nga vetë njësitë bazë akademike të universitetit<sup>10</sup> dhe miratohen në Senatin Akademik<sup>11</sup>. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, programi i studimit i Ciklit të Parë, “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit<sup>12</sup>, burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë dhe statutin e rregulloren e Universitetit ‘Eqrem Çabej’Gjirokastër, në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>   | <p>Programi i studimit në ciklin e parë “Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ofrohet nga Departamenti i Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, sipas standardeve ndërkombëtare të arsimit të lartë<sup>13</sup>, ku ofrohen gjithashtu programe studimi edhe në fushën e gjuhës shqipe, letërsisë shqipe, histori-gjeografi, gjuhëve të huaja, gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit grek<sup>14</sup>. Sipas evidencave dhe shqyrtimit të dokumentacionit, kurrikula e programit ka në fokus thellimin e njohurive në shkencat edukimit dhe metodologjisë në mësimdhënie, si dhe ky program, me strukturën e përmbajtjen e tij, është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në profilin e shkencave të edukimit.</p> |

<sup>8</sup> Evidenca I.1. Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

<sup>9</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025.

<sup>10</sup> Evidenca I.2.1 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e Rregullores së Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

<sup>11</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

<sup>12</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>13</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Baze të Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies.

<sup>14</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | Hartimi i programit të studimit, syllabusve të lëndëve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në vendin tonë dhe ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, dhe veçanërisht Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, të cilat janë përqëndruar në arsimin parashkollor <sup>15</sup> . |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ konstaton se institucioni i përmbush plotësisht këtë standartet e enteve rregullatore, në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe statutin e institucionit të lartë.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Programi i studimit në Ciklit të Parë, “Bachelor ” “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve <sup>16</sup> . Oferta akademike e studimeve të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është konceptuar për të formuar një brez të ri të formuar me një vështrim objektiv dhe kritik në shoqërinë në fushën e edukimit dhe metodologjisë së mësimdhënies, me profil në mësuesi për arsimin parashkollor. Këto objektiva pasqyrohen gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit.<br>Gjithashtu nëpërmjet guidës së studentëve, i bëhet e qartë studentëve misioni e objektivat formuese, si dhe kompetencat dhe aftësitë, që përftohen nga ndjekja e programit të studimit <sup>17</sup> . Duke qenë se në fokus të programit është kërkimi shkencor në fushën e mësimdhënies, studentët përpara fillimit të procesit mësimor, marrin edhe trajnim për përdorimin e bibliotekës <sup>18</sup> . |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së   | Bazuar dhe në dokumentacionin përkatës, si dhe nga vizita në IAL, GVJ-ja konstaton se njësi bazë nuk ka kryer një studim të tregut konkret në terren, por është bazuar në kërkesat e Drejtorive   |

<sup>15</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>16</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>17</sup> Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njesia Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

<sup>18</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

|  |  |                              |                             |   |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|---|
| <p>studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Arsimore Rajonale, për kërkesën e rritjes së numrit të mësuesve të parashkollor<sup>19</sup>.<br/>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të vazhduar u shërben studentëve të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.<sup>20</sup><br/>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, ka realizuar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme (si shkolla dhe kopështe: ‘Pandeli Sotiri’; shkollat 9- vjecare ‘Koto Hoxhi’ dhe ‘Urani Rumbo’, Kopshti ‘Cicërimat’ dhe Kopshit nr.4), të cilat krahas ndihmës për procesin mësimor kanë shërbyer si pikë tërheqjeje për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër.<sup>21</sup></p> |                              |                             |   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitimn e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>                    | <p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, si dhe nga vizita, GV-ja konstaton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programi të studimi të Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"<sup>22</sup>, si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitimn e dijeve, aftësive, shkathtësive të kompetencave, që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>  |                              |                             |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, nepermjet programit qe ofron ka perputhshmeri te plot me tregun e punes. Per kete arsye, institucioni, e permbush plotwsisht kete standart.</i></p>   |                              |                             |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht<br/><b>X</b></p> |

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

|                        |                                      |
|------------------------|--------------------------------------|
| <p><b>Kriteret</b></p> | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> |
|------------------------|--------------------------------------|

<sup>19</sup> Evidenca I.23. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër


<sup>20</sup> Evidenca II.18. Data bazë Alumni për punësimet e studentëve; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; [ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)

<sup>21</sup> Evidenca IV.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni. 14

<sup>22</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin parashkollor 2021-2022.



10



|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>  | <p>Programi i studimit i Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në Fakultet e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore<sup>23</sup>, të cilët kanë përvijën të gjatë dhe burimet akademike në fushën e edukimit dhe pedagogjisë<sup>24</sup>. Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në vitin për vitin akademik 2022-2023, përbëhet nga personeli akademik i programit me 21 (njëzetë e një) me kohë të plotë (PAE) dhe 2(dy) personel akademik me kohë të pjesshme (PAK). Këta pedagogë janë të kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (dy) Profesor Doktor</li> <li>• 7 (tetë) "Profesor i Asociuar"</li> <li>• 2 (dy) Lektorë me titullin Docent</li> <li>• 7 (nëntë) Lektorëme gradën "Doktor"</li> <li>• 4 (katër) Asistent-lektorë "Master i Shkencave",</li> <li>• 2 (dy) në proces doktrature<sup>2526</sup>.</li> </ul> <p>Personeli akademik ofronë kapacitetet profesionale të mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".</p> <p>Përvoja e stafit akademik dhe kërkimi i tyre shkencor, bazuar në të dhënat e siguruar nga institucioni, vizita në IAL dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ-ja konstaton se janë dëshmi e kapaciteteve akademike që Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, ofron për përmbushjen e qëllimit të ofrimit të ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".<sup>27</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjatë vizitës në ambientet fizike të institucionit, konstatoi se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"<sup>28</sup>, është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore<sup>29</sup>, që është Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe i shërben plotësisht misionit dhe vizionit të tij. Gjithashtu, ky program është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies dhe në shërbim të misionit të</p>  |

<sup>23</sup> Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njesia Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

<sup>24</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025.

<sup>25</sup> Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik 2022-2023.

<sup>26</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik të ftuar 2022-2023.

<sup>27</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>28</sup> Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

<sup>29</sup> Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njesia Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | tij <sup>30</sup> . Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", është në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Evropiane dhe Shqiptare të Kualifikimit.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Mbështetur në dokumentacionin përkatës, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.<br>Bazuar te kurrikula e programit, syllabuset e lëndëve, CV-të e stafit mësimdhënës si dhe veprimtaria kërkimore e shkencore e realizuar në kuadër të programit, evidentohet, si në fushën akademike, ashtu edhe kërkimore, orientimi i zhvillimit të programit në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e njësisë bazë në fushën e studimeve të edukimit, me qasje metodologjike dhe mësimdhënie. <sup>3132</sup> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | GVJ konstaton se program i studimit eshte ne perputhshmeri te plote me njesine baze, njesin kryesore dhe IAL.Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotesisht këtë standart.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

#### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Nga takimet e GVJ-së në institucion, dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, rezulton se është e qartësuar mirë ndarja në zbatimin e detyrave, të përcaktuara në rregullore, të njësisë e personelit lidhur me organizimin e mbarëvajtjen e programit të studimit. Veprimtaria e Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të |

<sup>30</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

<sup>31</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies

<sup>32</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022

|   |   |
|---|---|
|   | <p>përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.<sup>333435</sup></p> <p>Bazuar dhe në takimet e zhvilluara në IAL, u vërejt se analiza e vazhdueshme e punës së strukturave realizohet nëpërmjet treguesve të matshëm të realizimit të detyrave në formën e raportimeve tek drejtuesit e Departamentit ose Dekanatit, nëpërmjet takimeve periodike me titullarët, si dhe vlerësimit të performancës së pedagogut nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përgjegjësve të njësive të personelit. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”,<sup>36</sup> siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit mes Fakultetit të Shkencave të Natyrës me njësitë bazë të: Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, si dhe brenda njësisë kryesore të FESHSH-së, me njësitë bazë të: Historisë dhe Gjeografisë; Gjuhës Shqipe; Letërsisë Shqipe; Gjuhëve të Huaja; Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit, si dhe nëpërmjet marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.<sup>37</sup> Nga shqyrtimi i dokumenteve në dispozicion të GVJ-së, rezulton se njësitë bazë e përgjegjëse kanë të dokumentuar gjithashtu procedurat dhe analizat e vazhdueshme të punës së tyre.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p> | <p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, IAL garanton cilësinë dhe ligjshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që kontribuojnë në rritjen akademike të institucionit në përgjithësi dhe zhvillimin e profesionalizmit të stafit akademik, duke siguruar në veçanti realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.<sup>38</sup></p> <p>Në funksion të realizimit të programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, rezulton se janë nënshkruar marrëveshje me një numër të konsiderueshëm institucionesh institucione, si institucione të arsimit parashkollor dhe qendra për zhvillimin e arsimit me nxënës me aftësi ndryshe. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të</p>  |

<sup>33</sup> Evidenca I. 1.Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu II,III, IV, dhe V

<sup>34</sup> Evidenca I. 2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu II, III,IV dhe V

<sup>35</sup> Evidenca I.15. Organograma Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

<sup>36</sup> Evidenca I.12.4 Raporti vjetor Njesia kryesore FESHSH 2021-2022.

<sup>37</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBEMM për vitin akademik 2022-2023  
PAK

<sup>38</sup> Evidenca I. 11.6. Raporti vjetor Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër viti akademik 2021-2022

|   |  |
|---|--|
|   | bashkëpunimit <sup>39</sup> , pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale <sup>40</sup> .   |
| <b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Nga dokumentacioni përkatës të shqyrtuar prej GVJ-së, rezulton se institucioni e konsideron objektiv strategjik zgjerimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve.<br>Departamenti i i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies harton në mënyrë periodike relacione të veçanta për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për secilin aktivitet <sup>41</sup> të zhvilluar në institucion me bashkëpunëtorët <sup>42</sup> ose homologët në funksion të programit të studimit. <sup>4344</sup>  |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.           | Bazuar në tabelën përmbledhëse të institucioneve me të cilat IAL ka bashkëpunim, rezulton se Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore është në mbështetje të zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucione të tjera, si dhe bazuar dhe në intervistat e zhvilluara, IAL është në kërkim për kontakte të reja, duke hartuar politika për instalimin e bashkëpunimit <sup>45</sup> . Institucion në ka realizuar marrëveshje me institucione shtetërore sociale dhe arsimore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së praktikës së studentëve të programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.  | Bazuar në dokumentacion, si edhe në vizitat e kryera në institucion, GVJ-ja konstatoi se IAL në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare dhe Studentore ka organizuar disa trajnime në bashkërendim me punëdhënësit ose drejtuesit e disa institucioneve arsimore ose qendra të edukimit speciale në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shërbejnë për ngritjen profesionale, kryesisht të studentëve të diplomuar <sup>46</sup> . Trajnimet janë të natyrës objektive dhe praktike, kanë karakter aplikativ dhe i përgatisin studentët për karrierën e tyre në të ardhmen.  |

<sup>39</sup> Evidenca I.23. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

<sup>40</sup> Evidenca I. 11.4. Raporti vjetor Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër viti akademik 2020-2021

<sup>41</sup> Evidenca I.28 Raport projekti TeComp; Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie

<sup>42</sup> Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies (TeComp);

<sup>43</sup> Evidenca I.32 Projekti ENTRAL

<sup>44</sup> Evidenca II.31 Projekti TEAVET

<sup>45</sup> Evidenca I.31 Marrëveshjet institucionale për praktikën mesimore FESHSH.

<sup>46</sup> Evidenca III.15.3 Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | Një kujdes i veçantë i është kushtuar kontakteve me rrjetin Alumni, si dhe ofrimin ndaj tyre të mundësive të reja të zhvillim pas studimeve në bashkëpunim me institucione të ndryshme. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies njofton tëdiplomuarit për mundësitë e trajnimeve nëpërmjet faqes Alumni Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". <sup>47</sup>                               |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzion</b>                          | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, për të ofruar mundësi trajnimesh dhe bashkëpunimesh, nëpërmjet gjurmimit të studenteve të diplomuar. Gjithashtu, institucioni përmbush kapacitetet e duhura nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me insitucione dhe aktorë të tjerë e favor të fushave të studimit. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi II.1</b>  |  |
| <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe | Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin e ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", rezulton se programi i studimit me kohë të plotë është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) <sup>48</sup> . Programi realizohet në formën e studimeve me kohë të plotë dhe përfundon me marrjen e |

<sup>47</sup> Evidenca I.3. Strategjia e zhvillimit të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombetare, 31

<sup>48</sup> Evidenca I.4. Rregullore e studimeve Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër-së, Neni.11, pika 1;

|  |  |
|--|--|
| <p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>   | <p>diplomës. Siç është përcaktuar edhe në dokumentacion, specifikisht mbi misionin dhe objektivat e programit, organizimi i tij “realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit European të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.<sup>49</sup></p> <p>Elementet e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, janë në përputhje me (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018<sup>50</sup>.</p> <p>Pas plotësimit të kushteve për diplomim në përfundim studentit i jepet diplomë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.<sup>51</sup></p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> | <p>Në dokumentacionin përkatës të programit, përcaktohet si objektivi kryesor i tij synimi të përgatitjes së mësuesit të arsimit parashkollor me kulturë të gjerë pedagogjike, në nivelin universitar të ciklit të parë, ku në përfundim të studimeve, të mund të konkurrojnë në tregun e punës për t’u përgatitur si specialistë, mësues, etj. Realizimi i programit të studimit, bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese, si dhe ato të natyrës praktike. Studentët që do t’i nënshtrohen këtij programi studimi do të kenë njohuri të konsoliduara në fushën e arsimit parashkollor.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe në informacionin e dalë nga studimi i tregut, rezultojnë se programi ofron mundësi, që studentët të ndër marrin praktika në subjekte publike dhe jopublike. Nga takimet e zhvilluara në institucion, me stafin dhe studentët, rezultojnë se stafi akademik i përfshirë në këtë program kombinon të mësuarit me veprimtari shkollore dhe punë, bazuar në konsulentë dhe praktikën profesionale<sup>52</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik</p>        | <p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar nga GVJ-ja, dhe rregullores së programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, planet mësimore e syllabuset e lëndëve, si dhe nga biseda me stafin akademik dhe studentët e diplomuar, rezultojnë se ky program synon të japë një qasje të zgjeruar dhe të specializuar të koncepteve e</p>  |

<sup>49</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>50</sup> Evidenca II. 3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; II.3.1.

<sup>51</sup> Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Neni. 5.

<sup>52</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022



|  |  |
|--|--|
| <p>të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>  | <p>çështjeve themelore në fushën e arsimit parashkollor, si dhe fusha të tjera të lidhura e të përcaktuara në program<sup>53</sup>. Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ka si mision të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të formuar specialistë në fushën e arsimit parashkollor<sup>54</sup>, të aftë të konkurojnë në treg, si dhe të përballen me kërkesat në rritje të tregut të punës. Programi ka si qëllim gjithashtu të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve në profesionin e mësuesisë, duke i përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e saj me anë të promovimit të aftësive të mendimit kritik në problemet e edukimit, me interes publik.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Nga takimet e GVJ-së me stafin akademik dhe studentët e këtij programi, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, evidentohet se programi përfshin në kurrikulën e vet lëndë, që synojnë që të diplomuarit të kenë një formim kulturor, shkencor dhe profesional në nivele të përparuara.</p> <p>Kompetencat e programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” lidhen me aftësimin e të diplomuarit për të ofruar shërbime profesionale në fushën e arsimit parashkollor. Programi gjithashtu ndihmon dhe siguron, që studentët të marrin njohuri dhe kompetenca bazuar në nxënien në auditorë dhe në punën praktike, si dhe rrit aftësitë krijuese dhe aplikative tek ata.<sup>55</sup> Krahas këtyre, programi ofron mundësinë, që studentët të ndërmarrin praktika në subjekte publike dhe jopublike.</p> <p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program kombinon të nxënit me veprimtari dhe punë, bazuar në konsulencën dhe praktikën profesionale. Nga intervistat me studentët rezulton se pedagogët ofrojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e tyre akademik<sup>56</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>  | <p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, syllabuset e lëndëve, GVJ-ja konstaton se programi i ciklit të parë në Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, i përmban të gjitha elementët, që përbëjnë strukturën e programit të studimit.<sup>57</sup> Rregullorja mësimore e programit mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” e në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Struktura e studimeve për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, përfshin proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e</p>  |

<sup>53</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>54</sup> Evidenca II.27.1. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2022-2023

<sup>55</sup> Evidenca I.30. Rregullore e praktikave të FESHSH

<sup>56</sup> Evidencë II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” 2021-2022

<sup>57</sup> Evidencë II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” 2021-2022

|  |   |
|--|---|
|  | <p>punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit dhe janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar, i cili vlerësohet nga një komision i ngritur për të. Disiplinat që zhvillohen në programin e Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese. Lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur.</p> <p>Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra. Me përfundimin e këtij programi studimi, studentët pajisen me diplomë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, të shoqëruar me suplementin e diplomës, referuar niveli 6 të “Kornizës Shqiptare të Kualifikimit”.<sup>58</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit dhe syllabuseve të lëndëve rezultojnë se, në strukturën e programit janë të qarta ndarjet e veprimtarive formuese, që ofrohen në këtë program studimi. Ato grupohen në kategoritë e përcaktuara të veprimtarive formuese, si: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese e detyrimet përmbyllëse, me ngarkesën përkatëse në kredite, bazuar tek VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Gjithashtu, programet specifike të çdo lënde janë në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim dhe përfshijnë: pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin si dhe adresën elektronike të pedagogut.<sup>59</sup> Në vazhdim janë: zëri i përmbledhjes dhe rezultatit të të nxënit, konceptet themelore, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura si dhe zëri i vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Klasifikimi në programin e ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” sipas komponentëve mësimorë është:</p> <p>1- Lëndët bazë (30 kredite – 17 %), e ofruara në kategorinë e parë përcaktojnë formimin e përgjithshëm psikologjik, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme si Psikologji e përgjithshme, Psikologji zhvillimi, Psikologji edukimi, Kurrikula e arsimit parauniversitar, Alternativat e Arsimit parashkollor.</p> |

<sup>58</sup> Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës.

<sup>59</sup> Evidenca I.4. Rregulloren e studimeve në Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 23

|  |  |                               |                              |                               |
|--|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
|  | <p>2- Lëndët karakterizuese (99 kredite – 55 %); e ofruara në kategorinë e dytë lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim shkencor mbi Matematikën, Gjuhën shqipe, Letërsinë për fëmijë, Historinë, Gjeografinë, Fizikën, Biologji-kimi dhe njohuritë karakteristike të Edukimit qytetar, të Mendimit kritik dhe krijues, Edukimi me aftësi ndryshe, të Studimi i shkrimit akademik, të Edukimit fizik dhe të Kujdesi për veten.</p> <p>3-Lëndët ndërdisiplinore/integruese (27 kredite – 15 %) e ofruara në kategorinë e tretë janë lëndë të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit si Edukimi muzikor dhe didaktikë, Art pamor dhe didaktikë dhe grup-lëndë me zgjedhje. Prej këtyre të fundit, studenti duhet të zgjedhë 1 (nga) nga lëndët e ofruara si lëndë me zgjedhje.</p> <p>4-Lëndët plotësuese (18 kredite –10%); e ofruara në kategorinë e katërt përfaqësojnë veprimtari plotësuese të fokusuar për njohje të Gjuhës së huaj, Aftësive informatike dhe Praktikës profesionale.</p> <p>e. Detyrimet përmbyllëse, (6 kredite – 3%); Detyrime përmbyllëse lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin të përgjithshëm përfundimtar.<sup>60</sup></p> |                               |                              |                               |
| <b>Konkluzione</b>                         | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për përmbylljen e programit të studimit, nëpërmjet përputhshmërisë me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare. Për këtë arsye, institucioni, e përmbyll plotësisht këtë standart.</i></p>   |                               |                              |                               |
| <b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b> | <b>Nuk përmbyll</b>  | <b>Përmbyllhet pjesërisht</b> | <b>Përmbyllhet kryesisht</b> | <b>Përmbyllhet plotësisht</b> |
|  |  |                               |                              | <b>X</b>                      |

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyll kërkesat ligjore për këto njësi.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyll detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Referuar dokumentacionit të institucionit, konstatohet se Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, përgjegjës për programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, përmbyll detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti, bashkërendon dhe administron veprimtaritë akademike, kërkimore dhe shkencore në respekt të lirisë akademike të stafit mësimdhënës. <sup>61</sup> |

<sup>60</sup> Evidencë II.9.1 Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022 aneks-tabelat përmbyllëse, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

<sup>61</sup> Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 5, pika b

|   |   |
|---|---|
|   | <p>Bazuar verifikimeve të kryera nga RVJ-ja, rezulton se NJSBC bashkëpunon me departamentin për përmbushjen e veprimtarisë vlerësuese dhe hartimit të raporteve për cilësinë e programit të studimit.<sup>62</sup></p> <p>Me propozim të njësisë bazë, ngrihen grupet e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, të cilat miratohen dhe shpallen me vendim nga Dekani i Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga 6 (gjashtë) departamente, të cilat, bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore / tituj akademike, si dhe personel ndihmës akademik. Këto departamente janë:</p> <p>Departamenti Histori-Gjeografi,<br/>         Departamenti i Gjuhëve të Huaja,<br/>         Departamenti i Gjuhës Shqipe,<br/>         Departamenti i Letërsisë Shqipe,<br/>         Departamenti i Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek,<br/>         Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë<sup>63</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> | <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, caktohet koordinatori i programit, i cili mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, që mbulon për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivat e programit.<sup>64</sup></p> <p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe takimeve të zhvilluara në institucion nga GVJ-ja, njësia kryesore, për zhvillimin e saj më mënyrë efektive ngarkohen kryesisht personel akademik me kohë të plotë si përgjegjës dhe mësues të shkollave të cilët janë rekrutuar dhe si personel akademik me kohë të pjesshme në NJBEMM.<sup>65</sup> Ky program studimi ka specifikën e tij sepse në realizimin e disa programeve lëndore angazhohen dhe personel akademik nga njësitë bazë e tjera të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.<sup>66</sup> Sipas lëndëve përkatëse (Informatikë, Gjuhë e huaj, Gjuhë shqipe, Letësi për fëmijë, Njohuri për gjeografinë, Njohuri për historinë, Matematikë, Njohuri për Bio-kimin, Njohuri për fizikën, etj) angazhohet personel ndihmës akademik me karakter mësues të</p>  |

<sup>62</sup> Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenin 11, pika 3.

<sup>63</sup> Evidenca I.7. Rregullore e NJBEMM-së, Neni. 6

<sup>64</sup> Evidenca I.16. Organograma e NJBEMM

<sup>65</sup> Evidenca I.27. Rregullore për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrative në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Nenin 7, 8,

<sup>66</sup> Evidenca I.30. Paketa e praktikës mësimore/profesionale FESHSH

|   |  |
|---|--|
|   | <p>inkuadruar në Njësitë Bazë përkatëse. Koordinatori është përgjegjës për zhvillimin e programit dhe praktikave mësimore.</p> <p>Në analizën vjetore dhe mbledhjet e departamentit, raportohet për mbarëvajtjen e programit dhe të punës së tij, duke u ndalur në problemet që lidhen me stafin akademik, kurrikulën e mësimdhënies, shërbimet mësimore-studentore, administrimin, vlerësimin, programet akademike dhe kërkimore.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>GVJ-ja konstaton se, si njësia kryesore, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ashtu edhe njësia bazë, pjesë e strukturës së tij<sup>67</sup>, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, ofron programin e studimit i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Njësia bazë, funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe e punës kërkimore-shkencore të njësisë kryesore, që nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore edhe lidhur me programin e studimit.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies mbledhet të paktën një herë në muaj, duke kryer funksionet e tij, përmbush kërkesat dhe standardet e cilësisë për organizimin e programit nga pikëpamja infrastrukturore dhe nevojat kryesore për strukturën akademike dhe për kualifikimet e stafit akademik. Departamenti krahas stafit akademik ka në përbërje edhe personel administrativ, që administron dhe mirëmban dokumentacionin arsimor. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij.<sup>68</sup> Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies propozon edhe kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë e akteve nënligjore.<sup>69</sup> Departamenti për zgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit, si dhe të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencat Shoqërore.</p> |

<sup>67</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore

<sup>68</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit te personelit akademik te ftuar 2022-2023.

<sup>69</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>   | <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, si njësia përgjegjëse<sup>70</sup> për programin “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”<sup>71</sup> përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i programit përbëhet nga 21 (njëzetë e një) personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 2(dy) personel akademik me kohë të pjesshme (PAK). Këta pedagogë janë të kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (dy) Profesor Doktor</li> <li>• 7 (tetë) “Profesor i Asociuar”</li> <li>• 2 (dy) Lektorë me titullin Docent</li> <li>• 7 (nëntë) Lektorëme gradën “Doktor”</li> <li>• 4 (katër) Asistent-lektorë “Master i Shkencave”,</li> <li>• 2 (dy) në proces doktorature.</li> </ul> <p>Lektorët mbulojnë lëndë në përputhje me kualifikimet dhe interesat e tyre të kërkimit shkencor.<sup>71</sup></p> <p>Departamenti përcakton kriteret dhe nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, si dhe i propozon dekanit të fakultetit kandidaturat për personel akademik me kohë të plotë, sipas listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc.<sup>72</sup></p> <p>Stafi i Departamentit është</p> <p>9 PAE/10PAK v.a. 2020-2021<br/> 9 PAE/13PAK v.a. 2021-2022<br/> 9 PAE/10PAK v.a. 2022-2023<sup>73</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>GVJ-ja nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, i përmbahet kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë<sup>74</sup>, ku struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin, rregulloren dhe aktet e tjera të institucionit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.<sup>75</sup> Departamenti i Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, si njësia përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Aktualisht, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i programit përbëhet nga 21 (njëzetë e pesë) personel akademik me kohë të plotë (PAE<sup>76</sup>) dhe 2(dy) personel akademik me kohë të</p>  |

<sup>70</sup> Evidenca 1 Statuti i UGJ

<sup>71</sup> Evidenca IV.4 Propozim PAE ne NJBEMM.

<sup>72</sup> Evidenca IV.6 Procedure e punesimit per personel akademik me kohe te pjesshme NJBEMM.

<sup>73</sup> Evidenca IV.6 Procedure e punesimit per personel akademik me kohe te pjesshme NJBEMM.

<sup>74</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore

<sup>75</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

<sup>76</sup> Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit te personelit akademik 2022-2023.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>pjesshme (PAK)<sup>77</sup>, të cilët mbulojnë të gjitha nevojat për çdo lëndët dhe kurset e programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"<sup>77</sup></p> <p>Përgjegjësitë dhe kompetencat e partamentit janë të përcaktuara në aktet dhe rregulloren e brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë.<sup>78</sup></p> <p>Njësia bazë kordinon punën më njësinë përgjegjëse për të përmbushur detyrimet e organizimit të strukturës akademike.<sup>79</sup></p> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzion</b>                          | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, nepermjet programit te ofruar, ka perputhshmeri me aktet dhe dispozitat ligjore. Per këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart, nëpërmjet permbushjes se kerkesave ligjore.</i></p>   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>GVJ-ja konstaton se bazuar në dokumentacionin në dispozicion, institucioni disponon informacionet e nevojshme mbi programin e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e saj. Rregullorja e fakultetit,<sup>80</sup> departamentit<sup>81</sup> dhe e programit të studimit,<sup>82</sup> misioni e plani strategjik për programin, rregullorja e diplomimit, planet mësimore me syllabuset përkatëse të lëndëve, marrëveshjet me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese e partnerët, rregullorja e provimeve, transferimeve, praktikës, informacionet për trajnimet e studentëve e aktivitetet ekstrakurrikulare, si dhe mundësitë e orientimit dhe këshillimit për karriere, etj. janë pjesë e dokumentacionit që disponon departamenti, i cili është përgjegjës në organizimin e strukturës dhe përmbajtjen e programeve të studimit.</p> |

<sup>77</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik të ftuar 2022-2023

<sup>78</sup> Evidenca IV.8 Model Ngarkese Mesimore 2022-2023 NJBEMM.

<sup>79</sup> Evidenca IV.7 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik NJBEMM.

<sup>80</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore.

<sup>81</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>82</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mesuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>  | <p>Njësia disponon gjithashtu informacione nëpërmjet ngarkesës mësimore, planit të punës<sup>83</sup> dhe programin e aktiviteteve të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, specifikisht edhe për lëndët me module, të vlerësuara sipas sistemit të Krediteve Europiane ETCS, në përputhje të plot me përcaktimet ligjore në fuqi (specifikisht VKM Nr.41, datë 24.1.2018.<sup>84</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>  | <p>Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, përmban planin mësimor<sup>85</sup>, i cili hartohet nga njësia bazë dhe miratohet nga Senati Akademik. Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen<sup>86</sup>:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra.</li> <li>b. Kreditet përkatëse.<br/>dhe ka të përfshirë informacionin e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Format e veprimtarive mësimore (mësim, provime), numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave</li> <li>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave</li> <li>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese</li> <li>• Ngarkesën në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë</li> <li>• Komponentët mësimorë për secilen lëndë Formën e vlerësimit</li> </ul> </li> </ol> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <p>Në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, programi i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është organizuar në veprimtari formuese, të grupuara në lëndë bazë të programit të studimit, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, praktikë profesionale e detyrime përmbyllëse. Disiplinat grupohen mbi bazën e objektivave të tyre formuese, duke respektuar raportet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.<sup>87</sup> Sipas rregullores së programit, veprimtaritë formuese realizohen</p>  |

<sup>83</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>84</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>85</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>86</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>87</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.



|   |   |
|---|---|
|   | <p>nëpërmjet mësimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime), studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e punimit të diplomës/provim formimi) dhe praktika profesionale. Në planin mësues të programit përcaktohen lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, në vite e semestra, me kreditet përkatëse.</p> <p>Klasifikimi sipas komponentëve mësues për programin “programi i studimit i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është:</p> <p>F. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 7 lëndë, ose 19.5 % të planit mësues;</p> <p>G. Për përgatitjen Përgatitje për disiplinën shkencore – 21 lëndë, ose 53.4 % e planit mësues;</p> <p>H. Në lëndët ndërdisiplinore/integruese, përfshihen nëndisiplina dhe lende me zgjedhje - 6 lëndë, ose 13.8% te planit;</p> <p>I. Lëndët plotësuese përfshijnë 4 lëndë të planit, ose 10% të tij.</p> <p>J. Lëndët përmblyëse (provim/diplomë), 3.3 % të planit mësues.</p> <p>Lëndët dhe modulet e programit janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit të Krediteve Europiane (ECTS), të ndara në 6 semestra me kohëzgjatjen 3 vjeçare e që plotësojnë numrin total të 180 krediteve evropiane (ECTS).<sup>88</sup> Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite dhe 1.500 orë mësimore.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Studentët mund të marrin gjithashtu të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të tyre.</p> <p>Rregullorja Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Rregullorja e studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër,<sup>89</sup> si dhe Rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore<sup>90</sup> përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të studentëve, kuotat dhe kriteret e transferimit të studentëve në ciklin e parë të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, propozohen nga Njësia Bazë e Edukimit</p>   |

<sup>88</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>89</sup> Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni.49, Neni.61, Neni. 65

<sup>90</sup> Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Kreu IV

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë-së, Statutit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, dhe Udhëzimeve të MASR/MAS.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Nga shqyrtimi i rregullores e planit mësimor të programit i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, GVJ-ja konstaton se në to përmbahet informacioni i duhur për ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit. Programi mësimor i lëndës, jep në formë të përmbledhur strukturën e lëndës; përmbajtjen, orët përkatëse në auditor, duke i specifikuar në leksione dhe seminare, njohuritë paraprake të nevojshme për ndjekjen e lëndës, kushtet e veçanta në lidhje me frekuentimin dhe shlyerjen e detyrimeve para formës përfundimtare të vlerësimit. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës e miratohet, pasi konsultohet në departament. Formatin e syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të nxënies në përputhje me formatet e miratuara, sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe ndryshimet përkatëse <sup>91</sup> . |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.  | GVJ-ja konstaton se rregullorja e programit të studimit <sup>92</sup> parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm. Para fillimit të vitit të ri akademik bëhet po ashtu rishikimi i programeve, ku synohet të korrigjohen problemet, që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, duke përmirësuar dhe përditësuar elementë të ndryshëm të programit.  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>GVJ konstaton se institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart, nepermjet ofrimit te permbajtjes se programore. Programi i studimit është i formuluar në mënyrë të detajuar dhe informues, i mirëstrukturuar sipas objektivave formuese.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

<sup>91</sup> Evidenca I.4.Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI

<sup>92</sup> Evidenca I.4.Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>                        | <p>GVJ referuar dokumenteve të dorëzuar konstaton se ngarkesa e programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, ku programi është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 180 ECTS;</li><li>- 6 semestra (nga 30 ECTS), 2 semestra në çdo vit akademik.<sup>93</sup></li></ul> <p>Plani mësimor i programit është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e posaçme të programit dhe Kalendarin Akademik të IAL. Organizimi i programit realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS).<sup>94</sup> Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Programi i studimit Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike.<sup>95</sup> Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihen edhe koha për përgatitje dhe punë të pavarur të studentit. Ngarkesa e përgjithshme vjetore është jo më pak se 1500 orë.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p> | <p>GVJ-ja konstaton se, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë njohuri dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Struktura e studimeve për programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” përfshin proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit. Ato janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, praktikat profesionale,</p>   |

<sup>93</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>94</sup> Evidenca I.4. Rregullore e studimeve Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër-së, Neni.11, pika 1

<sup>95</sup> Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Neni. 5

|  |   |
|--|---|
|  | <p>testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Disiplinat që zhvillohen në programin e studimit të Ciklit të Parë, ‘Bachelor’ në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej IAL dhe njohuri të tjera formuese.</p> <p>Në tre vitet akademike janë bërë riorganizime në përmbajtjen e lëndëve në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, ku organizimi i lëndëve është bërë në veprimtari nga A-E, miratuar nga Senati në Rregulloren e studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër.</p> <p>A. Lëndët bazë (24 kredite – 13.5 %), përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme.</p> <p>B. Lëndë karakterizuese (105 kredite – 58.5 %); lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij.</p> <p>C.Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (27 kredite – 15 %); janë lëndë të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje. Prej këtyre të fundit, studenti duhet të zgjedhë 1 (nga) nga lëndët e ofruara.</p> <p>D.Lëndë Plotësuese (18 kredite –10%); përfaqësojnë veprimtari plotësuese të fokusuar për njohje të gjuhës së huaj, aftësive informatike, praktika formuese, sipas marrëveshjes së përbashkët dypalëshe, e nënshkruar për këtë qëllim etj.</p> <p>E. Detyrime Përmbyllëse (6 kredite – 3%); që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provim përfundimtar.<sup>96</sup></p> <p>Sipas shqyrtimit të dokumentacionit të IAL-së, GVJ-ja vlerëson së ndryshimet e bëra në kurrikul, janë të përputhshme të plot me legjisjlacionin e arsimit të lartë, dhe monitorohen nga njësia bazë dhe njësia kryesore.<sup>97</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p> <p>Objektivat formues të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” janë:</p>   |

<sup>96</sup> Evidencë II.9.1 Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022) [aneks-tabelat përmbledhëse, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

<sup>97</sup> Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni.23

|   |   |
|---|---|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ofrimi i program mësimit konkurrues bazuar në cilësinë e mësimeve dhe kurrikula bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së mësimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit parashkollor;</li> <li>- Formimi i profilit të edukimit dhe metodologjisë në mësime;</li> <li>- Profesionalizëm në mësuesi për arsimin parashkollor;</li> <li>- Promovimi i aftësisë së mendimit kritik dhe mësimeve sipas kushteve bashkëkohore;<sup>98</sup></li> </ul> <p>Oferta akademike e studimeve në këtë program studimi është konceptuar për të formuar qytetarë të pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këndvështrim objektiv dhe kritik në shoqërisë;</li> <li>- Aftësi dhe kapacitete për të ndikuar në profilin e mësuesisë dhe metodologjisë së mësimeve;</li> <li>- Metodatat e reja të mësimeve, për të qenë koherente me kushtet ndërkombëtare të edukimit.</li> </ul> <p>Studentët, që do të jenë pjesë e këtij programi studimi do të kenë njohuri në fushën e metodologjisë së mësimeve dhe edukimit, specifikisht në mësuesi për arsimin parashkollor; dije të përgjithshme të domosdoshme nga disiplina edukimi, metodologji dhe psikologjike; dije të specializuara teorike dhe analitike në nëndegëzime të mësuesisë, përfshirë edhe edukimin special dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta etj.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>GVJ-ja, nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, konstaton se kurrikula e programit, syllabusët dhe planet mësimore të tre viteve, struktura e tij, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite dhe raporti teori praktikë janë hartuar bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca nr. 1, Tab. nr. 1, i ndryshuar.<sup>99</sup> Ato janë në përputhje e me synim të realizimit të objektivave të programit.<sup>100</sup></p> <p>Të gjitha lëndët janë të pajisura me tekste përkatëse origjinale, të përkthyer ose leksione të përgatitura nga pedagogu i lëndës, ku studentët gjejnë parashtrimet themelore për lëndën.<sup>101</sup> Përveç teksteve, studentëve iu referohet literaturë plotësuese.<sup>102</sup><sup>103</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik</p>  | <p>Bazuar në dokumentacionin përkatës mbi programin, rezulton se organizimi i tij sipas llojit të veprimtarive formuese (A, B, C, D,</p>  |

<sup>98</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimit Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>99</sup> Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni. 6, Neni. 18, Neni. 26

<sup>100</sup> Evidenca II.9 Vendimi i Senatit Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022.

<sup>101</sup> Evidenca I.5. Rregullore e FESHSH-së, Neni. 11, Neni. 13

<sup>102</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimit Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>103</sup> Evidenca I.7. Rregullore e Njësisë Bazë EMM, Neni.6, Neni. 7

|  |   |
|--|---|
| <p>dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>                                      | <p>E) me lëndët bazë të formimit të përgjithshëm e përgatitjes metodologjike,<sup>104</sup> lëndët e formimit specifik, ndërdisiplinore e integruese; të veprimtarisë praktike e detyrimeve përmbyllëse etj. dhe përcaktimi i raporteve midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve, mobilitetit dhe punësimit në përfundim të studimeve. Vendosija në kurrikulën e programit të disa lëndëve dhe nga shkencat e tjera sociale u shërben objektivave më të gjëra të programit për studimin e mësimdhënies dhe metodologjitë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>      | <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, vizita në Bibliotekën e Fakultetit e biseda me stafin pedagogjik të programit, GVJ-ja konstaton se lëndët që zhvillohen për gjatë tre viteve akademike në programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse edhe të viteve të fundit. Vetë institucioni disponon një bibliotekë në shërbim të programit, ku krahas librave me specifikë edukimi, pedagogji dhe mësimdhënie gjenden dhe një pjesë e tezave të doktoraturave ndër vite mbrojtur në departament dhe arkivuar në bibliotekë.<sup>105</sup></p> <p>Në tërësi, përmbajtja e lëndëve dhe syllabuset përditësohen, si një kusht i detyruar i vënë nga departamenti, duke u azhurnuar edhe me tendencat e qasjeve moderne e shkencore në këtë disiplinë.</p> <p>Në programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, programet lëndore miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani dhe dorëzohen në departament.<sup>106</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Në takimet me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik të programit dhe studentët, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, GVJ-ja është i mendimit se përmbajtja e programit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.<sup>107</sup> Kjo del në pah nga shqyrtimi i dokumentacionit, te organizimi i kurrikulës, përmbajtjes së lëndëve, literaturës, programit të praktikës e aktiviteteve të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që shoqërojnë formimin e përgatitjen e studentëve përgjatë tre viteve akademike.<sup>108</sup></p>   |

<sup>104</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>105</sup> Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

<sup>106</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>107</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>108</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|  |  |                              |                             |  |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p><b>Kriteri 8.</b> Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>  | <p>Nga takimet e zhvilluara në IAL, të GVJ-së me dekanin dhe përgjegjësin e Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se programi është konceptuar i organizuar për të mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës të institucioneve publike dhe private të arsimit parashkollor, si dhe organizata të ndryshme joqeveritare, me profil edukimi.</p>  |                              |                             |  |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>Studentët nëpërmjet këtij programi fitojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme lidhur me zhvillimin e njohurive rreth arsimit parashkollor, metodologjië së mësimdhënies, edukimit si shkencë etj. Zhvillimet e reja në tregun e punës kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mësimore me qasje për rrirjtjm e aftësive, që kërkon tregu i punës. Për rrjedhojë në përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, institucioni ka zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktivitetesh konsultative, duke filluar që nga tryezat e rrumbullakëta me specialistë të fushës.<sup>109 110111</sup> Në të njëjtën kohë njësia bazë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut, si dhe shkëmbime ekspriencash nëpërmjet projekteve të ndryshme në fushën e edukimit.<sup>112</sup></p> <p>Nga takimi i GVJ-së, në institucion, me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se përmirësimi i përbajtjes së programit të studimit është në vëmendjen dhe objektivat e departamentit, duke përfshirë edhe rrjetin Alumni.<sup>113</sup></p> |                              |                             |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, sepse i përmbush plotësisht kuadrin european të edukimit të lartë. Gjithshtu, program është i strukturuar dhe organizuar në përbajtjen e tij, në përputhje të plot me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar.</i></p>  |                              |                             |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

**Standardi II.5**

<sup>109</sup> Evidenca I.28 Raport projekti TeComp.

<sup>110</sup> Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie.

<sup>111</sup> Evidenca I.32 Projekti ENTRAL.

<sup>112</sup> Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ.

<sup>113</sup> Evidenca II.18 Databazë Alumni.

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>  | <p>Nga shqyrtimi i CV-ve të veprimtarisë kërkimore – shkencore, edhe botuese të personelit akademik, i angazhuar në realizimin e programit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, rezulton se, si personeli akademik me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjesëshme, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.<sup>114</sup> Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie personel të kualifikuar me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, ka në përbërjen e tij për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i departamentit personeli akademik përbëhet nga 9 personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 10 personel akademik me kohë të pjesëshme (PAK). Këta pedagogë janë të kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 (dy) Profesor i Asociuar”</li> <li>• 3 (tre) Lektorë me titullin Docent</li> <li>• 3 (tre) Lektorë me gradën “Doktor”</li> <li>• 9 (nente) Asistent-lektorë “Master i Shkencave”,</li> <li>• 2 (dy) në proces doktore.<sup>115</sup></li> </ul> <p>Personeli akademik në Njësine Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies përbëhet nga pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe me kualifikime të spikatura në këtë drejtim. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive të përgjithshme bazë, njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara, aktuale dhe teorike si dhe e koncepteve më të gjera brenda fushave të studimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e</p>  | <p>GVJ-ja bazuar në shqyrtimin e CV-ve të personelit akademik,<sup>116</sup> konstaton se, personeli akademik mbulon programin e studimit, diploma, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike, përvoja e niveli i kualifikimit, veprimtaria shkencore, si dhe botuese e mëparshme dhe përgjatë zhvillimit të programit, janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Përveç personelit të kualifikuar me kohë të plotë, departamenti ka</p>  |

<sup>114</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik të ftuar 2022-2023.

<sup>115</sup> Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik të ftuar 2022-2023.

<sup>116</sup> Evidenca III.4. CV-të e Personelit Akademik në funksion të Programit të Studimit



|  |  |
|--|--|
| studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.  | aktivizuar për programin dhe lektorë me kohë të pjesshme dhe lektorë të departamenteve të tjera.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | GVJ-ja, gjatë vizitës në IAL, dhe takimeve me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik e studentët e regjistruar në programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se për orientimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, punimit të diplomës etj., është caktuar një staf i duhur akademik, me kualifikimin përkatës. <sup>117</sup> Specifikisht Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në bashkëpunim me njësinë kërkimore shkencore të fakultetit, promovon kërkime e studime krahasuese të pedagogëve dhe studentëve në fushat e shkencave të edukimit dhe metodologjisë së mësimdhënies. Bazuar në dokumentacion dhe takimet e zhvilluara në IAL, Departamenti është angazhuar në rrjetin e bashkëpunimit akademik e kërkimor me pedagogë e studentë të Institucioneve Arsimore të Larta homologe (specifikisht në Greqi). <sup>118</sup> Kjo është konkretizuar me organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin dhe zgjerimin dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe të rejat shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar. <sup>119</sup> |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.  | Bazuar në RVB-në, dokumentacionin përkatës të njësisë bazë, si dhe nga vizita e GVJ-së në mjediset e institucionit, rezulton se në shërbim të veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, si dhe në mbështetje të realizimit të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore ka një infrastrukturë efektive në shërbim të mbarëvajtjes së programeve që ofrohen. <sup>120121122</sup>  |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit. Njësia bazë ka personel akademik dhe ndihmës akademik, të cilët përmbushin kërkesat ligjore dhe kushtet e kualifikimit. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i>   |

<sup>117</sup> Evidenca I.30 Rregullore për praktikën mësimore

<sup>118</sup> Evidenca I.21.3 Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH 2021-2026.

<sup>119</sup> Evidenca I.26 Leksione të hapura.

<sup>120</sup> Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom.

<sup>121</sup> Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeeet.

<sup>122</sup> Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office 365.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                |                       |                      | X                     |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   |                |                       |                      | X                     |




### III MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| <b>Standardi III.1</b>  |  |
|---|--|
| <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>                               |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e institucionit, të njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që ofron programin në shqyrtim, GVJ-së konstaton se, që në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Planit Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Strategjisë së Zhvillimit të Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, Strategjisë së Zhvillimit të programi i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe Politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, përcaktohen si prioritet strategjik zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve<sup>123</sup>, lëndëve/moduleve, si një element i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike në çdo program studimi, që zhvillohet në njësitë bazë të këtij institucioni të arsimit të lartë.</p> <p>Për një mësimdhënie sa më efektive Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë krijoi kushtet e nevojshme për aksesimin nga ana e studentëve dhe personelit akademik<sup>124</sup> në këto platforma<sup>125</sup> nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i Universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik (manuale) për përdorimin e këtyre platformave në procesin e mësimdhënies dhe të të vlerësimit të të nxënit. <sup>126127128</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>           | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ-ja konstaton se në institucion dhe në njësitë përgjegjëse, funksionojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të procesit mësimor e performancës së personalit akademik dhe ndihmës akademik. <sup>129</sup>Përcaktuar me statut e sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, në rang institucioni funksionon NJSBC për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, e cila si formë të veprimtarisë së saj ka vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore,</p>   |

<sup>123</sup> Evidenca III.5 Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie

<sup>124</sup> Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;

<sup>125</sup> Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimin online;

<sup>126</sup> Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom

<sup>127</sup> Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeeet

<sup>128</sup> Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office 365

<sup>129</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

|   |   |
|---|---|
|   | <p>organizimin e pyetësorëve me studentët për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë të programeve të studimit dhe efikasitetin e programeve të ofruara. NJSBC evidenton përmbushjen e detyrave me hartimin e raporteve të vlerësimeve për çdo program studimi, të cilat shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe për vlerësimin e jashtëm.<sup>130</sup></p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>                                   | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe takimet e GVJ-së në IAL, të zhvilluara me drejtues, staf akademik dhe studentë të programit programi i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, NJSBC përfshin studentët në vlerësimin periodik në mënyrë anonime nëpërmjet një pyetësori, i cili realizohet çdo semestër dhe në përfundim të mbledhjes së të dhënave bëhet përpunimi i tyre dhe diskutimi i rezultateve.<sup>131</sup></p> <p>Në lidhje me ankesave për provimet, ato i paraqiten me shkrim përgjegjësit të departamentit. Nëse verifikohet gabimi, përgjegjësi i departamentit në bashkëveprim me komisionin e provimit bëjnë korigjimin. Në rast të pamundësisë së zgjidhjes së ankesës, vihet në dijeni dekani, i cili brenda ngre një komision ad-hoc, që bën verifikimin e pretendimeve të studentit.<sup>132</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>  | <p>Sipas dokumentacionit përkatës të shqyrtuar, si dhe takimeve të zhvilluara në institucion, me përfaqësues të NJSBC,<sup>133</sup> drejtuesve dhe stafit akademike, konfirmohet se është në praktikën e punës së institucionit, njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që rezultatet e procesit të vlerësimit, p<sup>134</sup>asi përpunohen nga struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit, posaçërisht përgjegjësit të departamentit, i cili ia bën të ditur personelit akademik.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Bazuar në takimet në institucion të GVJ-së, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se, ndërsa është krijuar një proces institucional vlerësimi për performancën e stafit akademik, konsiderohet si procedurë, që ndihmon për të kuptuar edhe shkallën e nevojave dhe përmirësimeve në këtë proces.<sup>135</sup> Drejtuesi i njësisë bazë u komunikon anëtarëve të stafit akademik, të dhënat nga vlerësimi i performancës së tyre në mësimdhënie, mbështetur tek pyetësorët e kryer. Bazuar në procesin e vlerësimit,<sup>136</sup> njësisia bazë promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon</p>   |

<sup>130</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>131</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>132</sup> Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021

<sup>133</sup> Evidenca VI.3.1 Antarët e NJSBC UGJ.

<sup>134</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>135</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>136</sup> Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022.

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies, si dhe harton konkluzione dhe rekomandime, të cilat përkthehen në plan masash për të inkurajuar dhe zhvilluar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik. <sup>137</sup> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ konstaton se institucioni, siguron monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit. Institucioni përvetëson politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilesisë në mësimdhënie. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i>     |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, rezulton se Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër e ka ndërtuar procedurën e format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të dijeve, në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi (VKM Nr.531, datë 24.01.2018). Procesi mësimor është i organizuar me leksione, seminare, detyra kursi, praktika profesionale, teste dhe provime semestrale dhe mbrojtje e diplomës/provim i përgjithshëm përfundimtar, si dhe zhvill ndërdisiplinor nëpërmjet workshop-e, seminare dhe konferenca shkencore.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë<sup>138</sup>, të cilët ndahen në: i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;<sup>139</sup> ii) studim individual, si studim e punimrelacionesh, detyrash apo projektesh; iii) përgatitje për provime; iv) përgatitje e tezës së diplomës; v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale,</p> |

<sup>137</sup> Evidenca I.12.4 Raporti vjetor Njesia kryesore FESHSH 2021-2022.

<sup>138</sup> Evidenca II.27.1. Programet lëndore( Syllabuset) e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”,viti akademik 2022-2023

<sup>139</sup> Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Kreu III

|  |  |
|--|--|
|  | <p>praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private<sup>140</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> | <p>Bazuar në takimet e realizuara në institucion, midis GVJ-së dhe përgjegjësit të njësisë bazë, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit<sup>141</sup> dhe studentë të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, evidentohet se personeli bën përpjekje t'u përgjigjet nevojave dhe diversitetit të studentëve, si dhe sugjerimeve të tyre lidhur me programin e mësimdhënien. Studentët e programi i studimi i Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” vijnë nga mjedise shoqërore e kulturore të ndryshme për këtë arsye stafi akademik është përpjekur të realizojë në mënyrë profesionale, detyrimin dhe me forma, metoda, aktivitete formuese e mundësi alternative mësimdhënieje t'u përgjigjet interesave e këndvështrimeve, si dhe aspiratave të auditorit.</p> <p>Personeli akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nxit gjithashtu studentin për të qenë pjesë aktive e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive, të cilat shoqërohen nga një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit, të cilat ndihmojnë në prezantime më cilësore.<sup>142</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>                       | <p>Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër realizon forma të ndryshme në mbështetje të personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike e përdorimin e metodave të reja pedagogjike. Kështu zhvillohen herë pas here nga IAL trajnime të ndryshme, të cilët rrisin performancën akademike dhe didaktike të lektorëve, si dhe nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme si rezultat i projekteve ndërkombëtare<sup>143</sup>, ku si rezultat i këtyre prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxënit, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar dhe përfshirë studentët.<sup>144</sup> Këto forma dhe metoda të mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre<sup>145</sup>.</p>   |

<sup>140</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, viti akademik 2021-2022

<sup>141</sup> Evidenca II.27.1. Programet lëndore( Syllabuset) e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”,viti akademik 2022-2023

<sup>142</sup> Evidenca II.9.1. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, viti akademik 2021-2022

<sup>143</sup> Evidenca II.32 TEAVET-modulet.

<sup>144</sup> Evidenca II.34 Projekt 2 Ndikimi i personalitetit dhe disiplineve pozitive NJBEMM.

<sup>145</sup> Evidenca II.33 Projekt 1 Modelimi i klasave te arsimit parauniversitar (1).

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>         | <p>Nga takimet e GVJ-së me stafin akademik edhe studente të programit, si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimit të tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezulton se titullarët e lëndëve kanë aftësi të pasura akademike dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore<sup>146</sup>.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies në përbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie vlerëson profilet e studimit dhe të specializimit të personelit akademik, interesat e tyre mësimore-kërkimore për të realizuar në fillim të çdo viti akademik, si dhe planifikimin e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik, që angazhohet në programin e studimit<sup>147</sup>. Departamenti merr gjithashtu në konsideratë: a) përvojën mësimore dhe kërkimore shkencore në fushën përkatëse; b) publikimet shkencore të realizuara në fushën përkatëse; si dhe c) gradën shkencore/titullin akademik që mban secili lektor.<sup>148</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Nga takimi i GVJ-së me përgjegjësin e departamentit, në institucion, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton kujdesi e përpjekja nga ana e institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve. Procesi i realizimit të vlerësimit të brendshëm, formë e të cilit janë edhe plotësimi i pyetësorëve<sup>149</sup> nga ana e studentëve, ndihmon në analizën<sup>150</sup>, reflektimin dhe përmirësimin nga ana e stafit pedagogjik të cilësisë së mësimdhënies, të didaktikës e metodologjisë së përdorur, literaturës, etj., të lidhur me programin.<sup>151</sup></p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>  | <p>Nga takimi i GVJ-së në institucion, me studentët e programit, konstatohet se stafi akademik përdorur metoda interaktive dhe diskutimi, që i bëjnë interesante e efektive orët e mësimi<sup>152</sup>. Përdorimi i këtyre metodave evidentohet në auditoret dhe në laboratorin e departamentit (i cili përdoret specifikisht për lëndët e arteve)<sup>153</sup>.</p>   |

<sup>146</sup> Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik 2022-2023.

<sup>147</sup> Evidenca I Statuti i UGJ.

<sup>148</sup> Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në arsimin Parashkollor 2021-2022.

<sup>149</sup> Evidenca III.6 Procedura e ngritjes së grupit të punës dhe zhvillimi i pyetësorit.

<sup>150</sup> Evidenca III.7 Analiza e pyetësorit dhe përcjellja në fakultete.

<sup>151</sup> Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.

<sup>152</sup> Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023

<sup>153</sup> Evidenca II.28.1 Stuktura mesimore viti 2022-2023 Arsim Parashkollor

|   |  |                              |                             |   |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Nga takimi i GVJ-së me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, rezulton se ekziston një marrëdhënie pedagog-student, një frymë pozitive e njerëzore komunikimi, si dhe bashkëpunimi në fushën e mësimdhënies. Studentët pohuan përpjekjen nga ana e stafit për të inkurajuar tek ata sensin e autonomisë, diskutimin e lirë, marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikim frytdhënës.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit, orët mësimore në auditor organizohen në orë leksioni dhe seminaresh. Orët e leksionit sikurse reflektohet edhe në planet lëndore janë orë mësimore të drejtuara nga pedagogu në funksion të orientimit të studentëve në kuptim dhe përvetësim të teorive dhe koncepteve lëndore. Bazuar edhe në dokumentacionin përkatës, orët e seminareve inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit për të hulumtuar dhe studiuar literaturë të rekomanduar ose alternative në mënyrë të pavarur jashtë auditorit, në funksion të përgatitjes paraprake për diskutim përgjatë orëve të seminarit. <sup>154</sup></p> <p>Marrëdhëniet pedagogë-studentë në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, specifiku në programin e studimit, karakterizohen nga një atmosferë bashkëpunimi e mirëkuptimi në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies, në gjetjen e formave e rrugëve sa më efikase në edukimin e tyre. Personeli akademik vendos për studentët orare konsultimi dhe takimi jashtë orëve mësimore, por në takimin e GJV-së konstatohet se ata i mirëpresin studentët edhe në oraret e tjera.</p> |                              |                             |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, i cili garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies, dhe aftësimin profesional dhe akademik. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>   |                              |                             |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht<br/><b>X</b></p> |

|   |                                      |
|---|--------------------------------------|
| <p><b>Standardi III.3</b></p>   |                                      |
| <p><b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin 40rofilng4040u duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p> |                                      |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi I ekspertëve</b></p> |

<sup>154</sup> Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023.






|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>   | <p>Nga takimet në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, GVJ-ja konstaton se institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra e të mirëmbajtura për zhvillimin e procesit mësimor e shkencor. Fakulteti I Fakulteti I Edukimit dhe Shkencave Shoqërore ka një sipërfaqe të shfrytëzueshme me dy turne mësimore, gjë që sjell dyfishimin e kapaciteteve të fakultetit.<sup>155</sup> Këto mjedise dallohen për nga ndriçimi i bollshëm natyror, sistemi i ftohjes dhe ngrohjes qendrore, që garanton kushte të favorshme për leksion.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>                                 | <p>Nga takimet e vizita në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë”, GVJ-ja konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Ekziston një lidhje e qëndrueshme Wifi, që shfrytëzohet 41rofil klasave gjatë mësimin dhe që ndihmon zhvillimin interaktiv dhe atë në 41rofilin të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies, si dhe gjithashtu ambientet e mësimdhënies janë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe monitorë, të cilat janë në shërbim të procesit mësimor për programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”<sup>156</sup>. Studentët dhe pedagogët janë të pajisur gjithashtu me një adresë postare elektronike nga institucioni, e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, 41rofilin 4141 lura të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>                 | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja vizitoji ambientet e institucionit, ku konsistohet se zyrat e personelit akademik janë të pajisura gjithashtu me 41rofilin, fotokopje dhe skanerë për të siguruar lehtësi në punën e personelit akademik në funksion të procesit mësimor.<sup>157</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të</p> | <p>Nga vizita në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë të GVJ-së, nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezultojnë se 41rofilin 41 bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike<sup>158</sup> dhe digjitale<sup>159</sup>) për disiplinat në përmbajtje të programit të studimit, është e aksesueshme për studentët në shqip, anglisht dhe gjuhë të tjera, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Si 41rofilin, tekstet mësimore me propozim të titullarëve të</p>  |

<sup>155</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

<sup>156</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

<sup>157</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

<sup>158</sup> Evidenca IV.11 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit.

<sup>159</sup> Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.

|   |   |
|---|---|
| parashikuara në programin e studimit.   | lëndëve, miratohen nga departamenti e u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik. <sup>160</sup><br>Studentët kanë mundësi gjithashtu të aksesojnë në kompjuterët e bibliotekës tituj të ndryshëm librash në PDF. <sup>161</sup> Biblioteka posedon po ashtu revista shkencore të shkencave sociale.  |
| <b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Nga vizita e GVJ-së në bibliotekën e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë <sup>162</sup> , nga biseda me personelin dhe nga shqyrtimi I dokumentacionin përkatës, rezulton se ajo disponon një numër botimesh, klasike dhe të reja, edhe të viteve të fundit, për fushat kryesore të programit dhe është në pasurim e sipër me tituj të rinj.  |
| <b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.   | Në bibliotekën e fakultetit, disponohet 42rofilin42 bazë dhe ndihmëse, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD-ROM, etj. Nëpërmjet aksesit në bibliotekën digjitale U-Library, JSTOR, COBISS+ ofrohen artikuj të revistave akademike, libra dhe dokumente (gjithsej 62.500 vëllime). <sup>163</sup><br>Biblioteka e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore ka një specifike të vecantë, për shkak të arkivave dhe materialeve të rëndësishme të mbledhura përgjatë shumë dekadave. |
| <b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.   | Gjatë vizitës në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, GVJ-ja konstatoi se IAL ka në dispozicion të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” bibliotekën dhe kompjuterë, të cilët shfrytëzohen nga studentët e programit për lëndët e programit për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës, apo studimeve specifike. <sup>164</sup>  |
| <b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor 42rofilin on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.  | Nga shqyrtimi I dokumentacionit përkatës të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, si dhe takimit të GVJ-së me personelin akademik e studentët, konstatohet se në funksion të mësimdhënies, shfrytëzohet efektivisht 42rofilin online (e-learning). <sup>165</sup>  |

<sup>160</sup> Evidenca IV.11.1 Biblioteka manuali i përdorimit.

<sup>161</sup> Evidenca IV.11.2 Rregulloret e Bibliotekës.

<sup>162</sup> Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.

<sup>163</sup> Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.

<sup>164</sup> Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.

<sup>165</sup> Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimin online.

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p> | <p>Nga shqyrtimi I dokumentacionit përkatës të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, si dhe takimit të GVJ-së me personelin akademik konstatohet se stafi dhe studentët kanë gjithashtu adresa elektronike, të cilat mundësojnë komunikimin midis tyre për çdo nevojë.<sup>166</sup></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>      | <p>Nga takimet e GVJ-së me stafin akademik, 43rofilin të programit, si dhe sekretarinë mësimore, konstatohet se me tematikën e diplomave të studentëve, që kanë përfunduar programin, procesi I përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomave zbaton rregulloret e institucionit që, për këtë qëllim, ka një dokumentacion të gjerë e të qartë. Udhëheqja e temave bëhet në përputhje me orientimin nga ana e personelit akademik dhe sipas 43rofilin të studentëve, në përshtatje me 43rofilin përkatës të pedagogut udhëheqës.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e njësisë bazë, si dhe nga takimet e GVJ-se, Departamenti I Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies nxit studentët me rezultate të larta dhe aftësi në kërkim, që në përfundim të detyrimeve përmbysë të programit të studimit të ciklit të parë, që të zgjedhin realizimin e një teme diplome. Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit I Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, personeli akademik dhe koordinatori I programit të studimit I orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, duke organizuar takime periodike me studentët, që plotësojnë kriterin për përzgjedhjen e temës së diplomës. Për çdo student, që zgjedh të bëjë temë diplome, departamenti cakton një pedagog udhëheqës, detyrat dhe të drejtat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren për diplomat e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”<sup>167</sup></p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ konstaton se institucioni nuk mbështet financiarisht stafin akademik, për publikime dhe mbështetje financiare në veprimtarinë studimore-kërkimore, por mundeson infrastrukturen komode për mesimdhënie. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |   |                              | <b>X</b>                    |                              |

**Standardi III.4**

<sup>166</sup> Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimimit online.

<sup>167</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.



| <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>   |   |
|---|---|
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi</b>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Universiteti i “Eqrem Çabej” Gjirokastër, për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies ka ngritur disa struktura si<sup>168</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila garanton cilësinë e aktiviteteve akademike, aktiviteteve kulturore dhe sociale të stafit akademik dhe studentëve, si dhe aktivitetet administrative,<sup>169</sup></li> <li>- Drejtoria e Shërbimeve Ndhmës Akademike-Administrative ;</li> <li>- Sektori i Shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll;</li> <li>- Sektori standarteve dhe i kurrikulave;</li> <li>- Sektori i shërbimeve bibliotekare arkivore dhe studentore;</li> <li>- Sektori i kerkimit shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë.<sup>170</sup></li> </ul> <p>Referuar statutit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik, i cili ngre komisionet e përhershme në nivel institucional. Krahas saj, organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe Bordi administrativ. Strukturat e ngritura nga ana e institucionit merren me koordinimin e veprimtarisë midis njësive kryesore dhe njësive bazë të programit të studimit sipas rregulloreve të tyre të brendshme.<sup>171</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron</p>   | <p>Referuar materialeve të depozituara si rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe e Departamentit Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, si dhe takimeve në institucion, GVJ-ja konstaton se Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si njësi kryesore mban përgjegjësi për rritjen dhe vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në të gjitha programet që ai ofron. Ndërkohë departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe ndjek proceset mësimore e kërkimore në bashkëveprim me stafin.<sup>172</sup></p>  |

<sup>168</sup> Evidenca; Faqja e zrytrare online: Organograma e Universitetit <https://uogj.edu.al/organograma-e-universitetit/>

<sup>169</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>170</sup> Evidenca I Statuti i UGJ.

<sup>171</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

<sup>172</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025.

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>   | <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje në lidhje me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte, detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë.</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Baza për zhvillimin e procesit mësimor në Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, janë rregulloret, Strategjitë e Mësimdhënies; Plani Strategjik i zhvillimit të departamentit, seminarët dhe trajnimet.<sup>173174</sup></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Referuar vizitës në institucion të GVJ-së me stafin, si dhe nëpërmjet dokumenteve të shqyrtuara, rezulton se Universiteti i “Eqrem Çabej” Gjirokastrë akordon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca.<sup>175</sup> Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet, mundësuar prej ERASMUS +, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>GVJ konstaton se botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science nuk janë të konsiderueshme. GVJ-ja rekomandonë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit dhe faktorizimin e universitetit në nivel ndërkombëtar.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>    | <p>Referuar takimit të GVJ-së në institucion me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe stafin, rezulton që IAL nxit stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, workshope. IAL ka zhvilluar gjithashtu trajnime dhe seminare të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësimdhënie, si dhe përdorimin apo implementimin e metodave të reja pedagogjike.<sup>176</sup></p>   |

<sup>173</sup> Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

<sup>174</sup> Evidenca I.21.3 Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH 2021-2026.

<sup>175</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025.

<sup>176</sup> Evidenca I.32 Projekti ENTRAL.

|   |   |                                     |                                    |   |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>                        | <p>Referuar takimeve të GVJ-së në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, si me drejtuesit, ashtu dhe me stafin, konstatohet se personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësi i stafit akademik dhe drejtuesit e fakultetit, janë të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Departamentit të Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies”.<sup>177</sup></p> |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p> | <p>Referuar takimeve të GVJ-së në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër konstatohet se personeli akademik teston metoda të reja në mësimdhënie<sup>178</sup>, ku p.sh. gjatë periudhës së pandemisë janë përdorur platformat e ndryshme online.<sup>179 180</sup></p>   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit. Njësia bazë dhe kryesore, garantojnë zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet vendosjes në dispozicion të infrastrukturës logjitime, fizike dhe didaktike. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   |   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |
| <p><b>Standardi III.5</b><br/> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>                                       |   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>   | <p>GVJ-ja nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër-së,<sup>181</sup> në Rregulloren e Fakultetit e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore,<sup>182</sup> në Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies,<sup>183</sup> në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe në programet mësimore të lëndëve të</p>                               |                                     |                                    |   |

<sup>177</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies

<sup>178</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies

<sup>179</sup> Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom.

<sup>180</sup> Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeeet.

<sup>181</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

<sup>182</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>183</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|  |  |
|--|--|
|  | <p>programit të studimit<sup>184</sup>. Në këto dokumente përcaktohet si formë kryesore e vlerësimit provimi. Kontrolli i dijeve bëhet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Kontrolli i vazhdueshëm përcaktohet nga lektorët në programet mësimore duke përfshirë forma të ndryshme si pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare, detyra kursi, punë minikërkimore, teste me alternativa dhe provimi përfundimtar. Në rregulloret e përmendura përcaktohen përgjegjësit për hartimin dhe miratimin e tezave të provimit, kriteret e futjes në provim për studentët, afatet e provimeve, mënyra e zhvillimit të provimit, procedurat e verifikimit dhe të sekretimit të provimeve, sistemi i vlerësimit me pikë, njohja e studentëve me rezultatet e provimeve, e drejta e anketimit etj.<sup>185</sup></p> <p>Gjatë takimit të GVJ-së me studentët, konstatohet se ata u shprehën që njihen me kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive që në orët e para të leksioneve, kur marrin programin e lëndës dhe i shpjegohen nga lektori i lëndës.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë GVJ-ja konstaton se titullari i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Gjithashtu i njih studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore<sup>186</sup>, Rregulloren e njësisë bazë<sup>187</sup> dhe në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>188</sup> është i përcaktuar qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo lënde apo moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga titullari i lëndës.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>                            | <p>Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë<sup>189</sup> dhe Rregulloren e Fakulteti të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, <sup>190</sup>forma kryesore e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore është provimi i cili realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Në rregulloren e programit të studimit,<sup>191</sup> specifikohet se përveç provimit vlerësimi mund të bëhet me detyra kursi, projekte, postera ose bazuar në një shumëllojshmëri formash të vlerësimit.</p>  |

<sup>184</sup> Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021.

<sup>185</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore

<sup>186</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore

<sup>187</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>188</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>189</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

<sup>190</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore

<sup>191</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|                    |   |                              |                             |                              |
|--------------------|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|                    | Gjithashtu në programet mësimore të lëndëve lektorët përdorin forma të ndryshme të vlerësimit bazuar në specifikat e lëndëve që zhvillojnë, si vlerësimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes së studentit, punët minikërkimore, testet me alternativa etj. <sup>192</sup> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b> | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, duke hartuar rregullore dhe procedura të testimit dhe vlerësimit të vazhdueshme. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i>                         |                              |                             |                              |
|                    | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|                    |   |                              |                             | X                            |

### Standardi III.6

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Bazuar në Rregulloren e Studimeve të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë-së, <sup>193</sup> Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, <sup>194</sup> Rregulloren e Programit të Studimit <sup>195</sup> janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit gjatë gjithë semestrit si aktivizim në mësim, si testimi i gjatë vitit/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet bazuar në mbledhjen e pikëve që ai merr në realizimin e këtyre detyrimeve: Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10-30 %; Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 10-30%; Testimet gjatë vitit 10-20 %; Provimi përfundimtar 60-90%; Përqindja e secilit komponent përcaktohet nga lektori i lëndës sipas specifikës së secilës lëndës. <sup>196</sup> Këto forma të vlerësimit të integruara nxisin studentët të mësojnë sistematikisht dhe në vazhdimësi gjatë zhvillimit të lëndës apo modulit. |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të     | Referuar të dhënave të deklaruara nga grupi i RVB-së, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ-ja konstaton se Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve  |

<sup>192</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>193</sup> Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

<sup>194</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>195</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>196</sup> Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023.



|   |   |
|---|---|
| <p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>   | <p>dhe për të shmangur subjektivitetin përdor sistemin Clean Score, në bashkëpunim me AADF. Ky sistem mundëson korrëgjimin automatik të pyetjeve me alternativa dhe në këtë mënyrë rritet shpejtësia e korrëgjimit dhe shmangen gabimet që mund të bëhen në korrëgjimin manual.<sup>197</sup></p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>                            | <p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, nga të cilët njëri është i brendshëm. Komisioni i provimit të një lënde përbëhet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njëri duhet të jetë pedagogu i lëndës.</p> <p>Anëtarët e komisionit të provimit të lëndës mbikëqyrin zhvillimin korrekt të tij. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të universitetit, me përjashtim të drejtuesit të njësise bazë dhe të njësise kryesore, anëtarëve të Rektoratit dhe personave të autorizuar me shkrim nga dekani ose rektori për të kryer kontroll.<sup>198</sup></p> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit diferencohen komisioni i vlerësimit (kur ka dy ose më shumë pedagogë të lëndës) dhe komisioni i provimit (titullari i lëndës dhe një pedagogë tjetër). Komisionet ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale.<sup>199</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p> | <p>Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Në Rregulloren e njësise kryesore<sup>200</sup> është e përcaktuar edhe mënyra e sekretimit nëpërmjet sekretimit të thjeshtë ose me sistemin BarCode. Këtë sekretim e bën komisioni pasi identifikon përmes dokumentit të identifikimit studentin. Më pas lista emërore me Barcode mbyllet në zarf, sekretohet dhe firmoset nga komisioni e i dorëzohet drejtuesit të departamentit për t’u ruajtur sipas procedurave të protokoll arkivës.<sup>201</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të</p>                              | <p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohet duke u mbështetur mbi kriteret e vlerësimit përfundimtar, si rezultat i të gjitha kontributeve të secilit në vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim. Teza e provimit, sipas Rregullore së Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore,<sup>202</sup> merr në konsideratë nivele të ndryshme njohurish duke filluar nga konceptet bazë për përvetësimin e një lënde deri tek njohuritë më të</p>   |

<sup>197</sup> Evidenca III.8 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ.

<sup>198</sup> Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Neni. 14, Neni. 16, Neni. 17, Neni. 18

<sup>199</sup> Evidenca III.10. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës Neni.25, Neni.26

<sup>200</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

<sup>201</sup> Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021.

<sup>202</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

|   |   |
|---|---|
| <p>ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>  | <p>përparuara, dhe duke përcaktuar një vlerësim të drejtë për secilin student.</p> <p>Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është përgjegjësi i departamentit ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit.</p> <p>Rezultatet paraprake të provimit me shkrim publikohen online (në sistemin ESSE3 tashmë në sistemin Pitagora) drei 6 (gjashtë) ditë nga data e zhvillimit të provimit. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatin e provimit nga studenti. Komisioni bën ballafaqimin me studentët gjatë 2 (dy) ditëve për të rishikuar provimin, për të kuptuar ku ka gabuar dhe për t'u këshilluar me pedagogun në vijim), deri në gjenerimin dhe publikimin e tyre.<sup>203</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>          | <p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, si Rregullorja e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies<sup>204</sup>, Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”<sup>205</sup>, në Kodin e Etikës<sup>206</sup> dhe programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, janë të shprehura qartë kërkesat dhe kriteret për të respektuar të drejtat e autorit<sup>207</sup> dhe për të realizuar punime origjinale në respekt të etikës së kërkimit., sikurse janë të specifikuar masat që ndërmerren në raste të shkeljes së tyre.</p> <p>Gjithashtu fakti që provimet realizohen nga komisione të përbëra nga të paktën dy pedagogë, rrit mundësinë për të shmangur kopjet dhe mosfunksionimin e etikës së provimeve.</p>   |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi akademik shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, tezat miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbalin e detyrimeve.<sup>208</sup></p> <p>Në Rregulloret e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë<sup>209</sup> dhe të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore<sup>210</sup> shkalla e</p>   |

<sup>203</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore FESHSH, Neni. 35, pika 6

<sup>204</sup> Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>205</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>206</sup> Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës.

<sup>207</sup> Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

<sup>208</sup> Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Neni.14,

Neni. 16, Neni.17, Neni.18

<sup>209</sup> Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Neni. 86, Neni.87, Neni.88

<sup>210</sup> Evidenca I.2. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni. 32, Neni.35

|   |  |
|---|--|
|   | <p>përvetësimin të programit mësimor vlerësohet në sistemin me notë. Për të përcaktuar notën përdoret sistemi i vlerësimit me pikë të cilat kthehen në notë. Rezultatet paraprake të provimit me shkrim publikohen online (në sistemin ESSE3 tashmë në sistemin Pitagora) drejtë 6 (gjashtë) ditë nga data e zhvillimit të provimit. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatit e provimit nga studenti. Komisioni bën ballafaqimin me studentët gjatë 2 (dy) ditëve për të rishikuar provimin, për të kuptuar ku ka gabuar dhe për t'u këshilluar me pedagogun në vijim), deri në gjenerimin dhe publikimin e tyre. Vlerësimi I përparimit të studentëve bëhet me notë, shkalla e përvetësimin të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është 5 (pesë); në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet detyrimisht me notë. Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas skemës nga 1-44 pikë për notën 4 deri tek 95-100 pikë për notën 10.</p> |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin dhe studentët e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, GVJ-ja konstaton se institucioni garanton të drejtën e studentit për t'u ballafaquar me vlerësimin e fituar nga realizimi i detyrimeve që i bëhen të qarta nga pedagogu që në orën e parë të leksionit dhe janë të vendosura edhe në sylabusin e lëndës. Studentit i njihet e drejta për t'u ankuar për rezultatit përfundimtar të provimit.<sup>211212</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>                           | <p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, GVJ-ja konstaton se studentëve i jepet e drejta që çdo kërkesë apo ankesë ta paraqesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit.</p> <p>Pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamertuar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të departamentit, i cili vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe, me urdhër, ngarkon një komision "ad hoc" (në përbërje të të cilit janë anëtarët e komisionit të provimit, por edhe pedagogë të tjerë) që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Vendimi që merr ky komisioni "ad hoc" mbi rivlerësimin e provimit është i formës së prerë dhe depozitohet në</p>  |

<sup>211</sup> Evidenca I.4. Rregullore e studimeve të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 45, Neni.46

<sup>212</sup> Evidenca I.2. Rregullore e Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër-se, Neni. 90

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | departament dhe në sekretarinë mësimore. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në system. <sup>213</sup>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, në kuadër të ruajtjes së dokumentacionit, si dhe hartimit të procedurave për transparencën e vlerësimit. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve   |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | <p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në fushën e programit të studimit. Referuar dokumentacionit të paraqitur, plani mësimor për programin e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” përmban:<sup>214</sup></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lëndët bazë (24 kredite – 13.5 %), përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme.</li> <li>2. Lëndë karakterizuese (105 kredite – 58.5 %); lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij.</li> <li>3. Lëndë Ndërsipinore/Integruese (27 kredite – 15 %); janë lëndë të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje. Prej këtyre të fundit, studenti duhet të zgjedhë 1 (nga) nga lëndët e ofruara.</li> <li>4. Lëndë Plotësuese (18 kredite – 10%); përfaqësojnë veprimtari plotësuese të fokusuar për njohje të gjuhës së huaj, aftësive informatike, praktika formuese, sipas marrëveshjes së përbashkët dypalëshe, e nënshkruar për këtë qëllim etj.</li> <li>5. Detyrime Përmbyllëse (6 kredite – 3%); që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provim përfundimtar.<sup>215</sup></li> </ol> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet</p> |

<sup>213</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 46, pika 2

<sup>214</sup> Evidencë II.9.1 Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>215</sup> Evidencë 4.2 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)

|  |  |
|--|--|
|  | propozohen nga njësia bazë dhe miratohen fillimisht nga dekani dhe më pas nga Senati Akademik. <sup>216</sup>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ-ja konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje dhe në zbatimin të VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. <sup>217</sup><br>Program i studimit përmban lëndë bazë, ndërdisiplinore dhe plotësuese të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e metodologjisë dhe mësimdhënies.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.                         | Programi i studimit, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, <sup>218</sup> bazuar në kornizën konceptuale, ka si synim të pajisë studentët me disa kompetenca dhe aftësi të cilat përpunohen në pjesën më të madhe me kompetencat dhe aftësitë që synojnë lëndë të ndryshme përmes silabuseve/ programeve të lëndëve. Referuar dokumentacionit këto kompetenca dhe aftësi janë objekt i analizës dhe diskutimeve.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.   | Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit të shqyrtuar si edhe takimit të GVJ-së me stafin akademik dhe studentët e programit ‘Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, <sup>219</sup> në përfundim të çdo lënde apo moduli personeli akademik diskuton me studentët çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.  |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.                                    | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, RVJ-ja konstaton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies organizon aktivitete shkencore me një numër pjesëmarrësish të konsiderueshëm. <sup>220</sup> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. <sup>221</sup> Personeli akademik pranë NJBEMM ka organizuar trajnimet gjatë vitit akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 me mësuesët e Arsimit Parauniversitar, të cilët janë pajisur me certifikatat (me e kredite), zyrtarisht nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër. Për koordinimin e trajnimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) <sup>222</sup> |

<sup>216</sup> Evidenca I.4. Rregulloren e studimeve në Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni. 23

<sup>217</sup> Evidencë 4.2 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)

<sup>218</sup> Evidencë II.9.1 Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>219</sup> Evidencë II.9.1 Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, 2021-2022

<sup>220</sup> Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2022-2023;

<sup>221</sup> Evidenca III.15.4 Listë me personat që kanë dhënë mësim ose kanë bërë punë kërkimore në një universitet perëndimor

<sup>222</sup> Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës;

|   |  |
|---|--|
|   | <p>e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve <i>TEAVET</i>.<sup>223</sup></p> <p>Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe NJBEMM, ka qenë <i>project partner</i> në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit erasmus+.<sup>224</sup></p> <p>Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.<sup>225</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>      | <p>Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orientuara drejt lidhjes së ngushtë të dijeve të metodologjisë dhe mësimdhënies në arsimin parashkollor me kontekstin bashkëkohor, teoritë dhe paradigmat orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e mësimdhënies. Studentët orientoohen drejt praktikave mësimore në mënyrë që të rrisin aftësitë përshtatëse në tregun e punës si mësues të arsimit parashkollor. Gjithashtu Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies i ofron studentëve shumë mundësi për zhvillimin e praktikave mësimore, ku mund të zhvillojnë njohuritë e fituara.<sup>226</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>                            | <p>Referuar programeve të lëndëve të programit të studimit programi i të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në pjesën më të madhe të silabuseve është e përcaktuar që një pjesë e pikëve të vlerësimit fitohen nga studentët me anë të pjesëmarrjes dhe diskutimit në leksione dhe seminare për tema të ndryshme, realizimit të detyrave në grup, realizimit të minikërkimeve shkencore në grup etj.<sup>227</sup> Këto motivojnë dhe nxisin studentët për të shprehur pikëpamjet e tyre.</p>   |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> | <p>Personeli akademik i Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative duke e bazuar vlerësimin e studentit jo vetëm përmes provimit por edhe përmes formave të tjera të kontrollit të dijeve si pjesëmarrje në diskutime mbi çështje aktuale, përgatitje e detyrave të kursit në grup ose individuale, përgatitje e punëve minikërkimore si pjesë për vlerësim në shumë silabuse të</p>   |

<sup>223</sup> Evidenca II.32. Modulet TEAVET, Evidenca II. 35 Modulet ASCAP;

<sup>224</sup> Evidenca: Projekt-TeComp, <http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events>

<sup>225</sup> Evidenca III.15.5 Liste e profesoratit të huaj të angazhuar në dhënie e titujve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër).

<sup>226</sup> Evidenca I.31 Marreveshjet institucionale për praktikat mesimore FESHSH.

<sup>227</sup> Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023.

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | programit etj. <sup>228</sup> Këto forma të stimulimit të studentëve për të vënë në zbatim njohuritë e fituara në lëndë/modulet e zhvilluara, e bëjnë leksionin më të tërheqës dhe nxisin studentin të zhvillojë mendimin kritik dhe ide novative për zgjidhje të problemeve të ndryshme sociale.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.  | Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit, institucioni ofron mbështetje akademike për studentët duke i ndihmuar ata për zhvillimin e karrierës dhe mbështetje për procedurat e mobilitetit të studentëve.<br>Referuar RVB-së si dokumentacioni i IAL-së, Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër i akordon një fond vjetor Këshillit Studentor si mbështetje për aktivitetet dhe implementimin e ideve novatore, por nuk ka asnjë të dhënë mbi këtë fond dhe numrin e studentëve që kanë përfituar nga ai. <sup>229</sup>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e disponuar Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi. Referuar dokumentacionit është e dallueshme që Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies organizon leksione të hapura, seminare dhe aktivitete të ndryshme me pedagogë, specialist dhe ekspertë të institucioneve bashkëpunuese.<br>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies ka edhe raste të mobilitetit të stafit përmes projekteve europiane të shkëmbimit Erasmus dhe projekteve ndërkombëtare. <sup>230</sup><br>Sugjerohet që të punohet më shumë për të rritur numrin e studentëve të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” të cilët marrin pjesë në mobilitete dhe shkëmbime. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, nëpërmjet ofrimit të njohurive të nevojshme, si dhe kompetencave shkencore dhe profesionale, për të nxitur aftësitë krijuese të studentët. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

### Standardi III.8

<sup>228</sup> Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023.

<sup>229</sup> Evidenca I. 25 Lista e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

<sup>230</sup> Evidenca I. 25 Lista e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

| <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>  |   |
|---|---|
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.   | RVJ-ja mbështetur në dokumentacionin e paraqitur konstaton se, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka procedura të posaçme për provimin final ose temën e diplomës dhe kjo është e njohur për studentët. Në Rregulloren e Programit të Studimit, <sup>231</sup> përcaktohet se studenti për të fituar diplomën duhet të japë provimin final ose të mbrojë një punim diplome. Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës janë të përcaktuara në Rregulloren për Diplomat e Ciklit të Parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ku specifikohet se kush ka të drejtë të realizojë një punim diplome, si zgjidhet, përcaktohet e miratohet tema e diplomës, zgjedhja e udhëheqësit, të drejta dhe detyrimet, si ngrihet komisioni i vlerësimit, struktura e punimit dhe kriteret mbi etikën e studimit. Për Studentët që nuk plotësojnë kriterin e notes mesatare, vihet në dispozicion nga departamenti një program studimi për provimin e formimit. <sup>232</sup> |
| <b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.        | Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies nëpërmjet personelit akademik asistojnë studentët duke i vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme përmes Programit të Provimit të Formimit dhe Rregullores për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. <sup>233234</sup>   |
| <b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Referuar dokumentacionit, GVJ-ja konstaton se në semestrin e dytë të vitit të tretë, departamenti harton dhe miraton programin e provimit të formimit të cilin e përcjell për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore. Programi i referohet lëndëve të zhvilluara përgjatë 3 viteve të studimeve. Komisioni i hartimit të tezës kujdeset që të jetë gjithëpërfshirës në tezën që harton me pyetje nga program i studimit të shpërndarë tek studentët. <sup>235</sup>   |
| <b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final  | Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies ka në dispozicion të studentëve një rregullore për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, <sup>236</sup> në këtë rregullore janë të përcaktuara  |

<sup>231</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>232</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullores së studimeve.

<sup>233</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>234</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullores së studimeve.

<sup>235</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullores së studimeve.

<sup>236</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.



|   |  |
|---|--|
| apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.  | kriteret, të drejta dhe përgjegjësi të udhëheqësit, struktura e temës dhe të tjera elementë të nevojshëm për të ndihmuar studentët në përpilimin e temës së diplomës. Në këtë rregullore është e përcaktuar se udhëheqësi duhet të bëj transparent kalendarin e takimeve për konsultime, të japë mbështetje akademike për formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës, përgatitjen e punimit etj. <sup>237</sup>  |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.  | Referuar dokumentacionit, GVJ-ja konstaton së stafi akademik ndihmonë studentët me kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma kërkimore. <sup>238</sup> Studentët mund të përdorin ambientet e fakultetit për shkrimin e punimit etj. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies dhe personeli akademik asiston studentët në lehtësimin e kryerjes së matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucione apo jashtë tij sepse kjo është e përcaktuar në rregulloren e përgatitjes së diplomës. <sup>239</sup>                                   |
| <b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Bazuar në Rregulloren për e Ciklit të Parë të studimit si dhe në manualin e punimit të diplomës, udhëheqësi ka përgjegjësi të takojë studentin për konsultime, të japë mbështetje akademike në formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë, rekomandimin e literaturës, konsulencën për përgatitjen e punimit. Ai ka detyrimin të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës, të mbajë takime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit, të vlerësojë progresin dhe monitorojë standardin e punës së tij, si dhe të japë ose jo leje për mbrojtje. <sup>240</sup> |
| <b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.  | Në përfundim të provimit të formimit ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me pikë të cilat konvertohen në notë sipas sistemi të vlerësimit. Për vlerësimin e punimit të diplomës, ngrihet nga përgjegjësi i departamentit një komision i cili përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, dhe miratohet nga dekani. Komisioni në fund të prezantimeve bën vlerësimin e tyre me notë. Në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret e vlerësimit. <sup>241</sup>   |
| <b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.   | Referuar dokumentacionit, GVJ-ja konstaton se, me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme studentët, që kanë plotësuar kërkesat e planit mësimor dhe kanë dhënë provimin e formimit/temën e diplomës, pajisen me Diplomë Universitare   |

<sup>237</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullorese se studimeve.

<sup>238</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mesuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>239</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullorese se studimeve.

<sup>240</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit të diplomës, shtojca e rregullorese se studimeve.

<sup>241</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mesuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | “Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” të shoqëruar me listën e notave si dhe me suplementin e diplomës. <sup>242</sup>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.  | Bazuar në Statutin e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, studenti pasi pajiset me Diplomë Universitare të miratuar nga Ministria e Arsimit ka në dispozicion një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, e cila është e detajuar edhe në suplementin e diplomës. <sup>243</sup>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Institucioni bazuar në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, <sup>244</sup> përcaktohet se sekretaria mësimore administron, mirëmban e ruan regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave; procesverbalet e provimeve; dosjet me dokumentacionin e regjistrimit dhe të ç’regjistrimit të studentëve dhe dokumentacionin statistikor përkatës; arkivon dosjet e studentëve të diplomuar.<br>Gjatë vizitës të GVJ-së në institucion, specifikisht në sekretari, u konstatua se institucioni ruan në mënyrë të rregullt regjistrat zyrtar të studentëve. Sekretarisë ju kërkua vënia në dispozicion e regjistrit të studentëve, e cila ishte plotësuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura për programin e studimit, në kuadër të përmbushjes së dokumentacionit, në aspektin e procedurave dhe përgatitjes së dokumentacionit të diplomimit. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush plotësisht këtë standart.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<sup>242</sup> Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës

<sup>243</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>244</sup> Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Bazuar në RVB e programit të studimit si dhe gjatë vizitës në institucion, për tre vitet e fundit akademike (2020-2021, 2021-2022 dhe 2022 -2023), konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies.

Bazuar në RVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit BA Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, bazuar në Tabelat 6<sup>245</sup> është:

| Tituj/grada | 2022 -2023 |          | 2021 -2022 |          | 2020 - 2021 |          |
|-------------|------------|----------|------------|----------|-------------|----------|
|             | PAE        | PAK      | PAE        | PAK      | PAE         | PAK      |
| Prof.Dr     | 1          | -        | 1          | -        | -           | -        |
| Prof.As.Dr  | 7          | -        | 7          | -        | 5           | -        |
| Dr/PhD      | 7          | -        | 6          | 1        | 8           | -        |
| Docent      | 2          | -        | 2          | -        | 2           | -        |
| Dr proces   | 2          | -        | -          | -        | 0           | -        |
| Msc         | 2          | 2        | 6          | 2        | 3           | -        |
| Në total    | <b>21</b>  | <b>2</b> | <b>22</b>  | <b>3</b> | <b>18</b>   | <b>0</b> |

Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu I, pika 3.3.c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, evidentohet se numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar (PAK) me atë me kohë të pjesshme (PAE) është i qëndrueshëm.

<sup>245</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 6.

|  |  |
|--|--|
|  | Për vitin akademik 2022-2023, rezulton se raporti PAK dhe PAE është 21-2 (91.3%- 8.7%).  |
| <b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.  | Konstatuam se, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies (NJBEMM), mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” <sup>246</sup> .   |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.                           | Bazuar në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së burimeve njerëzore konstatuam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik dhe të studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore pranë shkollave përkatëse <sup>247</sup> .<br><br>Gjithashtu, në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektësi në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi <sup>248</sup> .  |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Konstatuam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore <sup>249</sup> .<br><br>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të departamentit. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit <sup>250</sup> . |

<sup>246</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 4.

<sup>247</sup> Evidenca IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023. Evidenca I.27 Rregullore për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe administrativ.

<sup>248</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 6.; Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

<sup>249</sup> Evidenca IV.6 Procedure e punësimit për personel akademik me kohe të pjesëshme NJBEMM.; Evidenca IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesëshme dhe kohëzgjatje të caktuar.; Evidenca IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar.

<sup>250</sup> Evidenca IV.3.3 Model dosje personeli NJBEMM (1).; Evidenca IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesëshme dhe kohëzgjatje të caktuar.; Evidenca IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar.

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>   | <p>Konstatuam se, FESHSH ka punonjës ndihmës për realizimin e këtij program studimi në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore si dhe në realizimin e orëve laboratorike, për natyrën specifike të këtij program studimi<sup>251</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatuam se FSHSHE dispononte disa laboratorë në fuksion të këtij program studimi si laborator i edukimit figurativ, edukimit muzikor, i teknologjisë në edukim, të cilët administrohet nga lektorët përkatës, stafi ndihmës mësimor si dhe nga specialisti i IT i FSHSHE-së<sup>252</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UGJ<sup>253</sup>, në lidhje me strukturën analitike të FSHSHE, në rang njësie dhe personelin përkatës.</p> <p>Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të cilat arkivohen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të UGJ-së<sup>254</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>  | <p>Institucioni “UGJ” rezulton se ka marrëveshje bashkëpunimi me DRAP Fier, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor për realizimin e praktikës profesionale dhe punës kërkimore të studentëve në terren për realizimin e temës së diplomës.</p> <p>UGJ merr përsipër deklarin e studentëve praktikantë lidhur me sigurimet shëndetësore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.</p> <p>Nga ana tjetër, ZVA Gjirokastër, merr përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë<sup>255</sup>.</p> |

<sup>251</sup> Evidenca I.15 Organograma Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore.

<sup>252</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

<sup>253</sup> Evidenca IV.3.3 Model dosje personeli NJBEMM (1).

<sup>254</sup> Evidenca IV.7 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik NJBEMM.: Evidenca IV.8 Model Ngarkese Mesimore 2022-2023 NJBEMM.

<sup>255</sup> Evidenca I.31 Marrëveshjet institucionale për praktikën mesimore FESHSH.

|  |   |                              |                             |  |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritis. Personat përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e praktikës, profesionale mësuesi mentor dhe pedagogu përgjegjës, ndihmojnë studentët në realizimin e praktikës pasive dhe më pas asaj aktive<sup>256</sup>.</p> <p>Në Rregulloren e praktikës profesionale është e përcaktuar qartë “Dosja e studentit”, e cila përmban formularët që janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, ku paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuara përgjatë zhvillimit të procesit mësimor<sup>257</sup>.</p> |                              |                             |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit.</i></p> <p><i>Konstatuam gjithashtu, se Zyra e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të departamentit dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program.</i></p> <p><i>Përsa me sipër, ky kriter ligjore të përmbushet plotësisht.</i></p>   |                              |                             |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Standardi IV.2</b><br/> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p> |  |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën</p>   | <p>Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se UGJ e ushtron aktivitetin e tij në tre godina universitare. Pjesa me e madhe e kurseve të këtij program studimi, zhvillohen në godinën e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe infrastruktura e universitetit përmban mjedise me përmasa normale dhe me kushte mjaftueshmërisht të mira fizike për</p> |

<sup>256</sup> Evidenca I.30 Rregullore për praktikën mësimore; Evidenca II.28.1 Stuktura mësimore viti 2022-2023 Arsim Parashkollor.; Evidenca I.31 Marrëveshjet institucionale për praktikën mësimore FESHSH.

<sup>257</sup> Evidenca I.30 Rregullore për praktikën mësimore

|   |   |
|---|---|
| specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.  | zhvillimin e mësimdhënies, por dhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore <sup>258</sup> .   |
| <b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita në institucion, konstatoam se, disa nga mjediset mësimore, si: laboratorët <sup>259</sup> dhe biblioteka janë të pajisura me mjete e duhura elektronike dhe teknologjike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, si dhe veprimtaritë artistike përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit ndërsa auditorët, në të cilët zhvillohen leskionet dhe seminarët kanë kushte të normale fizike.<br><br>Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira normale për akomodimin e studentëve në këtë program studimi <sup>260</sup> .   |
| <b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.                | Nga vizita e mjediseve, konstatoam se, klasat mësimore janë të pajisur me mjetet minimale, të nevojshme për realizimin e procesit mësimor si banga, karrike dhe tabela.<br><br>Evidentuar se, FSHSHE ka një laborator laboratorit pedagogjik <sup>261</sup> , laboratorin e informatikes <sup>262</sup> , salla për zhvillimin e kursit të artit figurativ, salla për zhvillimin e artit muzikor që janë të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor në kuadër të specifikes që ky program studimi ka.<br><br>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatoam se mjediset mësimore si zyra, studiot, klasat, laboratorët, sallat e performancës, janë të pajisuara me mjetet e nevojshme fizike, teknike, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e kurseve që ky program studimi ofron për aftësimin teorik dhe praktik si dhe artistik <sup>263</sup> . |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.  | Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se, UGJ disponon 3 laborator kompjuterik në Godinën B, ku në çdo laborator janë të instaluar mbi 30 pajisje kompjuterike të ndërlidhjes së rrjetit Lan dhe Wifi internet. Gjithashtu, Rezulton, se në Godinën A të UGJ-së ndodhet Laboratori i Multimedia-s që shërben gjithashtu si laborator informatike <sup>264</sup> .  |

<sup>258</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

<sup>259</sup> Evidenca III.3 Inventar i laboratorit pedagogjik.

<sup>260</sup> Evidenca III.2 Inventaret e mjeteve didaktike NJBEMM.

<sup>261</sup> Evidenca III.3 Inventar i laboratorit pedagogjik.

<sup>262</sup> Evidenca I.14 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër., Evidenca III.2 Inventaret e mjeteve didaktike NJBEMM.

<sup>263</sup> Evidenca II.28.1 Stuktura mesimore viti 2022-2023 Arsim Parashkollor.

<sup>264</sup> Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ.

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | Të gjithë laboratorët janë në shërbim të studentëve me internet falas që iu vjen në ndihmë për përgatitjen e detyrave të kursit dhe diplomave. Interneti falas në këtë mjedis krijon kushte të favorshme për një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si dhe të mësuarin në distancë. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UGJ, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik <sup>265</sup> . |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i></p> <p><i>Gjithashtu konstatojmë se institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira normale për akomodimin e studentëve në këtë program studimi. Auditorët, në të cilët zhvillohen leskionet dhe seminarët kanë kushte të mira fizike.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi IV.3</b>  |   |
| <b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>                                    |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | <p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit e aktiviteteve të ndryshme artistike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatojmë se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga<sup>266</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Literatura bazë;</li> <li>- Literatura ndihmëse;</li> <li>- Periodik të huaj;</li> </ul> |

<sup>265</sup> Evidenca I.14 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

<sup>266</sup> Evidenca IV.10.1 Te dhena per NJBEMM nga BIBLOTEKA.



|  |  |
|--|--|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Periodik shqiptare;</li> <li>- Enciklopedi;</li> <li>- Revista Shkencore;</li> <li>- Punime teorike të pedagogëve;</li> <li>- Monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi edukim, letersinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe.</li> </ul>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.  | Konstatohet se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron <sup>267</sup> .  |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.   | <p>Nga vizita në institucion, konstatohet se biblioteka e UGJ-së, është e vendosur në godinën C të institucionit.</p> <p>Biblioteka ofron një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre sallën e internetit si dhe tre salla leximi.</p> <p>Shërbimi elektronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Sistemi i menaxhimit përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shfaqjen përmes shfletuesit publik (COBBIS/OPAC) për audiencën e gjërë;</li> <li>● Sistemi i arkivit digjital ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike<sup>268</sup>.</li> </ul> |
| <b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | <p>Konstatohet se biblioteka e UGJ-së, sot disponon një fond prej rreth 62.300 librash. Fondet e bibliotekës në shqip dhe në gjuhë të huaj mbulojnë të gjitha fakultetet e universitetit.</p> <p>Gjithahstu biblioteka zotëron<sup>269</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tituj dhe botime shkencore 5400 tituj (4000 gjuhë shqipe dhe 1400 të huaj);</li> <li>- Revista dhe periodike shkencore 26 tituj (21 gjuhë shqipe dhe 5 të huaj);</li> <li>- Monografi shkencore 1140 tituj (900 gjuhë shqipe dhe 240 të huaj);</li> </ul>   |

<sup>267</sup> Evidenca IV.10 Kerkese per blerje librash NJBEMM.

<sup>268</sup> Evidenca IV.11.1 Bibloteka manuali i perdorimit.

<sup>269</sup> Evidenca IV.10.1 Te dhena per NJBEMM nga BIBLOTEKA.

|   |   |
|---|---|
|   | <p>- Tituj librash 9700 tituj (7300 gjuhë shqipe dhe 2400 të huaj);</p> <p>- Katalogimi elektronik 1900 tituj.</p> <p><i>Mungon informacioni se sa tituj ka në dispozicion për këtë program studimi.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>   | <p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, menaxhimi i librave të bibliotekës është i realizuar nëpërmjet skedarëve dhe gjithashtu nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p>Rezulton se, Biblioteka e UGJ disponon 3 salla leximi (me 13+10+30 vende, 53 vende në total)<sup>270</sup>, që ndihmon studentët në realizimin e detyrave të kursit në grup dhe stafit akademik për kërkimin shkencor<sup>271</sup>.</p> <p>Ndërsa nëpërmjet katalogut COBBIS ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Revista Elektronike</u></li> <li>• Libra elektornike</li> <li>• Akses në biblioteka të ndryshme</li> </ul> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>   | <p>Rezulton se, Biblioteka ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në mjediset e sallave të leximit që disponon.</p> <p>Gjithashtu, në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve mundësi aksesimi në librarine dixhitale U-Library<sup>272</sup></p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se, Biblioteka funksionon nëpërmjet Regjistrimit themeltar të inventarit të koleksioneve bibliotekare, i cili është dokumenti bazë që pasqyron të gjitha materialet bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë që në krijimin e saj në mënyrë kronologjike. Regjistri i inventarit është dokument mbi bazën e të cilit bëhet inventari i bibliotekës. Në të rregjistrohet çdo njësi që hyn në bibliotekë dhe merr një numër që e identifikon atë si njësi unike midis tërë koleksionit të bibliotekës<sup>273</sup>.</p>   |

<sup>270</sup> Evidenca IV.10.1 Te dhena per NJBEMM nga BIBLOTEKA. Evidenca IV.11.1 Biblioteka manuali i perdorimit.

<sup>271</sup> <https://ulibrary.rash.al/>

<sup>272</sup> <https://ulibrary.rash.al/>

<sup>273</sup> Evidenca IV.11.2 Rregullore e Bibliotekës.

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve aksesimin në bibliotekën digjitale të <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a> dhe oraret e shërbimit, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve.<br><br>Biblioteka punon nga e hëna në të premte përgjatë orarit 8:00 – 19:00.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Konstatohet se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve.<br><br>Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron <sup>274</sup> , por për shkak të mungesës së fondeve jo gjithmonë realizohen kërkesat e paraqitura për pasurimin e fondit të titujve. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka e UGJ disponon një fond të pasur fizik dhe elektronik me libra në gjuhën shqipe dhe të huaj, por ka nevojë të pasurohet me botime shkencore në funksion të këtij program studimi.</i><br><br><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              | X                           |                              |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi IV.4</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.  | Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, sekretaria mësimore disponon statistika vjetore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit;</li> <li>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;</li> </ul> |

<sup>274</sup> Evidenca IV.10 Kerkese per blerje librash NJBEMM.

|   |   |
|---|---|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;</li> <li>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;</li> <li>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik;</li> <li>• të dhënat e studentëve që diplomohen<sup>275</sup>.</li> </ul> <p>Gjithashtu, konstatojmë se, informimi i studentëve, realizohej nëpërmjet sistemit Pitagora, por aktualisht institucioni nuk ka akses dhe është në proces për riaktivizimin e marrëveshjes me RASH.</p> <p><i>Rekomandohet të realizohet, sa më parë, marrëveshja ndër-institucionale për aktivizimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit në UGJ.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Bazuar në Raportin vjetor të punës mësimore-shkencore të stafit akademik të UGJ<sup>276</sup> dhe Planit të aktiviteteve vjetore të departamentit<sup>277</sup>, rezultojnë se institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Gjithashtu, rezultojnë se, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike dhe Administrative, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik<sup>278</sup>. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor<sup>279</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>   | <p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatojmë se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna në formatin e Regjistrimit Themelort të Studentëve dhe Regjistrimit e Diplomimit<sup>280</sup>.</p> <p>Ashtu sikurse konstatojmë edhe më sipër në, kriterin IV.4.1, institucioni nuk ka akses në sistemin Pitagora për hedhjen dhe ruajtjen e të dhënave në mënyrë elekttronike.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të</p>  | <p>Nëpërmjet sistemit PITAGORA, rezultojnë se institucioni menaxhonte sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepën të dhënat e</p>   |

<sup>275</sup> Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.; Evidenca Tabela ASCAL BMAP.

<sup>276</sup> Evidenca III.15.2 Plan i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.;

<sup>277</sup> Evidenca III.15.3 Plan i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM.;

<sup>278</sup> Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA.

<sup>279</sup> Evidenca IV.7 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik NJBEMM.; Evidenca VI.4.2 Propozim për planin e zhvillimit të FESHSH 2021-2026.

<sup>280</sup> Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.

|   |   |                                     |                                    |                                     |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>   | <p>aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.</p> <p>Ndërsa në kuadër të projektit Erasmus + “ TeComp”, piloti platformën elektronike “Learning Key” duke vëri në dispozicion të studentëve programin e lëndës, leksionet, materialet &amp; video mësimore, video prezantimet e studentëve, si dhe realizon takime online<sup>281</sup>.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>Bazuar në Rregulloren e FSHSHE-së, e Njesisë bazë të Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies<sup>282</sup> si dhe në rregulloren e programit të studimit<sup>283</sup>, rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>       | <p>Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të UGJ-së, janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UGJ, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht<sup>284</sup>.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, konstatojmë se, informimi i studentëve, realizohej nëpërmjet sistemit Pitagora, por aktualisht institucioni nuk ka akses dhe është në proces për riaktivizimin e marrëveshjes me RASH.</i></p> <p><i>Rekomandohet të realizohet, sa më parë, marrëveshja ndërinstytucionale për aktivizimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit në UGJ.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |

<sup>281</sup> Evidenca IV.15 Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key.

<sup>282</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.: Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë bazë të Edukimit dhe Metodologjisë Mesimdhënies.

<sup>283</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mesuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>284</sup> <https://uogj.edu.al/>

|  |  |  |   |  |
|--|--|--|---|--|
|  |  |  | X |  |
|--|--|--|---|--|

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>  | <p>Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili, pasi hartohet nga Administratori, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë<sup>285</sup>.</p> <p>UGJ, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj<sup>286</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Ndërsa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit<sup>287</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>   | <p>Konstatuam që, UGJ i është nënshtruar një auditimi financiar në Korrik të vitit 202, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”<sup>288</sup>.</p>   |

<sup>285</sup>Evidenca IV.13.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025..

<sup>286</sup> Evidenca IV.13.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022.

<sup>287</sup> Evidenca IV.13.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022.

<sup>288</sup> Evidencë 5.3 Njoftim e Raport Auditimi.

|  |   |                             |                            |   |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>  | <p>Konstatohet se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatohet se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përse i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera<sup>289</sup>.</p>   |                             |                            |   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p> | <p>Konstatohet se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UGJ, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, <i>por nga ana tjetër numri i vogël i studentëve të regjistruar në këtë program studimi pasqyron vështirësinë për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</i></p>  |                             |                            |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Nga ana tjetër rënia e numrit të studentëve, vit pas viti, pasqyron vështirësinë për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i></p> |                             |                            |   |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përbushet</p>  | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

|  |                      |                             |                            |   |
|--|----------------------|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b></p> | <p>Nuk përbushet</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |
|--|----------------------|-----------------------------|----------------------------|---|

<sup>289</sup> Evidenca IV.14.2 Raport i MAS AUDIT 2022.

<sup>289</sup> Evidenca IV.13.1 Raport vjetor financiar për vitin 2020.; Evidenca IV.13.2 Raport vjetor financiar për vitin 2021.; Evidenca IV.13.3 Raport vjetor financiar për vitin 2022.

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| <b>Standardi V.1</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.            | Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UGJ ka hartuar Statutin, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e FESHSH-së, Rregulloren e NJBEMM-së, Rregulloren e Studimeve <sup>290</sup> , të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit <sup>291</sup> .<br><br>GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e këtij programi të studimit <sup>292</sup> si dhe Manualin e punimit të diplomës, shtojca e rregullore së studimeve <sup>293</sup> . |
| <b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.   | Konstatojmë që, institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullore së programit të studimit dhe Rregulloren e studimeve në UGJ ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi <sup>294</sup> .<br><br>Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e  | Rezulton se përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga NJBEMM dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit "Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor" <sup>295</sup> , duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për  |

<sup>290</sup>Evidenca 1 Statuti i UGJ., Evidenca 2 Rregullore e brendshme e UGJ.; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.; Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.

<sup>291</sup> Evidenca II.20 Procedura e transferimit te studimeve dhe e programit te dyte te studimit 2022-2023 FESHSH.

<sup>292</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.; Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>293</sup> Evidenca III.11.1 Manuali i punimit te diplomes, shtojca e rregullores se studimeve.

<sup>294</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.; Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>295</sup> Evidencë 2.4 Vendim për miratim kuotash; Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.



|   |   |
|---|---|
| <p>studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>   | <p>kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta<sup>296</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UGJ, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UGJ, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p>Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit, të cilat janë të publikuara edhe në web faqen zyrtare të UGJ:</p> <p><a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhene/">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhene/</a></p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Rregullorja e studimeve në UGJ, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<sup>297</sup></li> <li>● Udhërrëfyesi për studentët, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultet, programet e studimit si dhe stafin akademik<sup>298</sup></li> <li>● Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit<sup>299</sup>.</li> <li>● Kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor<sup>300</sup></li> </ul> |

<sup>296</sup> Evidenca II.13.3 Kriteret e pranimit të studentëve 2023-2024 dhe miratimi i kuotave 2022-2023.; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuara.

<sup>297</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>298</sup> Evidenca V.15 Udhërrëfyesi për studentet.

<sup>299</sup> Evidenca II.27 Miratimi i syllabusave NJBEMM 2022-2023.; Evidenca II.27.1 Programet lëndore Arsim Parashkollor 2022-2023.

<sup>300</sup> Evidenca II.28. Stuktura mesimore viti 2022-2023 Arsim Parashkollor.

|   |   |
|---|---|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>● Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin<sup>301</sup>.</li> </ul> <p>Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e FESHSH-së, në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e e studimeve në UGJ si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Rezultojnë se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi<sup>302</sup>.</p> <p><a href="http://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/">http://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</a></p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UGJ-së, janë të publikuara plan programet e programeve të studimit që institucioni ofron:</p> <p><a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhene/">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhene/</a></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>            | <p>Konstatojmë se, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UGJ ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UGJ, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron<sup>303</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>  | <p>Rezultojnë se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi.</p>   |

<sup>301</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>302</sup> Evidencë 2.4 Vendim për miratim kuotash.

<sup>303</sup> Po aty.

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.   | <a href="http://uogj.edu.al/upload/Plan%20kuota%20dhe%20kriteret/Kriteret%20bachlor%202024-2025">http://uogj.edu.al/upload/Plan%20kuota%20dhe%20kriteret/Kriteret%20bachlor%202024-2025</a> )<br>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UGJ, gjendet në çdo kohë, Rregulloret dhe Kriteret për pranimin e studentëve.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | UGJ ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, Ballkano dhe Egjiptianë si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit <sup>304</sup> .   |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimin në programet e studimit që ofron UGJ, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të web-it. Gjithashtu, konstatohet se UGJ, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk Përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi V.2</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.   | Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UGJ, sipas fakulteteve përkatëse. ( <a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-</a> |

<sup>304</sup> Evidencë 2.4 Vendim për miratim kuotash.. Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta.; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020.; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuar., Evidenca II.14.3 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë.

|   |   |
|---|---|
|   | <p>edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhene/) si dhe materiale fizike udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Udhërrëfyes për studentët, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultet, programet e studimit si dhe stafin akademik<sup>305</sup>.</li> <li>● Kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor<sup>306</sup></li> <li>● Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit<sup>307</sup>.</li> <li>● Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore<sup>308</sup>, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore si dhe vlerësimin dhe diplomimin nëpërmjet Manualit të punimit të diplomës<sup>309</sup>.</li> <li>● Rregullorja e studimeve në UGJ, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<sup>310</sup></li> </ul> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të</p> | <p>Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e</p>  |

<sup>305</sup> Evidenca V.15 Udhërrëfyes për studentet.

<sup>306</sup> Evidenca II.28.1 Stuktura mesimore viti 2022-2023 Arsim Parashkollor.

<sup>307</sup> Evidenca II.27.1 Programet lendore Arsim Parashkollor 2022-2023.

<sup>308</sup> Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.

<sup>309</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022. Evidenca III.11.1 Manuali i punimit te diplomes, shtojca e rregullores se studimeve.

<sup>310</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

|   |   |
|---|---|
| <p>kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>  | <p>shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin<sup>311</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>  | <p>Konstatohet se bazuar në Rregulloren e FESHSH-së, në Rregulloren e studimeve të UGJ-së, si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor<sup>312</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>  | <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor dhe Rregulloren e studimeve në UGJ janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi<sup>313</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se NJBEMM, në fillim të vitit të parë të studimeve nëpërmjet “Ditëve të hapura” informon kandidatët për studentë për strukturën dhe programet e studimit që institucioni ofron. Gjithashtu, gjatë javës së parë të studimeve studentët e rinj prezantohet me stafin akademik të përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës<sup>314</sup>.</p> |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban program i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së Programit të</i></p>   |

<sup>311</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>312</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.; Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze të Edukimit dhe Metodologjisë Mesimdhënie; Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.; Evidenca II.8 Plan mësimor Bach. Arsimi Parashkollor 2018-2019.

<sup>313</sup> Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.; Evidenca I.9 Rregullore programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022.

<sup>314</sup> Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023., Evidenca IV.11.2 Rregullore e Bibliotekës.

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk Përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

| <b>Standardi V.3</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.  | <p>Konstatohet që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës npernjmjet Rregullores së Njesisë Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.; Rregullores së Njesisë bazë të Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies si dhe Rregullores së programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor 2001-2022<sup>315</sup>, ku përcaktohet qartë organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit</p> <p>Rezulton, gjithashtu, se ne faqen zyrtare të web-it të UGJ-së, studentët mund të aksesojnë inrofmacion rreth strukturës dhe orgazinimit të programit të studimit.<br/><a href="https://uogj.edu.al/">https://uogj.edu.al/</a></p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.   | Rezulton se, në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor <sup>316</sup> , përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, si dhe nëpërmjet Udhërrëfyesit për studentët, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultet,  |

<sup>315</sup> Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore.; Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjise Mesimdhënies.; Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.;

<sup>316</sup> Evidenca I.9 Rregullore programit te studimit Bachelor ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor 2001-2022.

|  |  |
|--|--|
|  | <p>programet e studimit si dhe stafin akademik<sup>317</sup>. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UGJ<sup>318</sup>.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet lektorëve të departamentit studentët informohen për kurset, syllabuset, detyrimet, mungësitë që institucioni ofron.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>  | <p>Konstatohet se Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Ajo i orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon<sup>319</sup>.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies në bashkëpunim me DRAP Fier, informon studentët mbi mundësitë e punësimit pranë institucioneve arsimore që ofrojnë Arsimin Parashkollor<sup>320</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, NJBEMM nëpërmjet lektorëve në bashkëpunim me Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës<sup>321</sup>. Në faqen e internetit të UGJ, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët si dhe një hapësirë dedikuar studentëve ku mund të informohen rreth programit të studimit dhe mundësive që institucioni ofron në dispozicion të tyre (<a href="http://uogj.edu.al/">http://uogj.edu.al/</a>).</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>   | <p>Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se, informimi i studentëve, realizohej nëpërmjet sistemit Pitagora, por aktualisht institucioni nuk ka akses dhe është në proces për riaktivizimin e</p>   |

<sup>317</sup> Evidenca V.15 Udherrefyces per studentet.

<sup>318</sup> <http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-sc-mesimdhenie/>

<sup>319</sup> Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA.; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës.

<sup>320</sup> Evidenca I.31 Marreveshjet institucionale per praktikat mesimore FESHSH.

<sup>321</sup> Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës.

|  |  |                              |                              |
|--|--|------------------------------|------------------------------|
| të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | <p>marrëveshjes me RASH, ashtu sikurse konstatuam edhe në standardin IV.</p> <p>Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online në faqen zyrtare dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë<sup>322</sup>.</p>   |                              |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që në faqen e internetit të UGJ gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UGJ dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët</i></p> <p><i>Zyra e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Në Mësuesi për Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> |                              |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>                     |  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b>  |
|  |  |                              | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi V.4</b>  |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.   | <p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit, Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH 2021-2026; Plani Strategjik i Njesisë bazë EMM; Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM; si dhe Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023. rezulton se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtaritë e kryera<sup>323</sup>.</p> <p>Konstatohet, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që UGJ ofron, specifikisht Programin e Studimit</p> |

<sup>322</sup> <http://uogj.edu.al/>

<sup>323</sup> Evidenca I.21.3 Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH 2021-2026.; Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.; Evidenca VI.4.2 Propozim për planin e zhvillimit të FESHSH 2021-2026.; Evidenca III.15.3 Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM.; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.



|  |  |
|--|--|
|  | <p>Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor, rezultojnë të regjistruar<sup>324</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2022-2023 është 17 studentë</li> <li>- Për vitin akademik 2021-2022 është 7 studentë</li> <li>- Për vitin akademik 2020-2021 është 5 studentë</li> </ul>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizita ne institucion, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi<sup>325</sup>.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit konstatuam se, ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e tyre.</p> <p>Rezulton se, Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit në bashkëpunim me sektorn mësimor, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit<sup>326</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>  | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e FESHSH-së disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit,</p>   |

<sup>324</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 21

<sup>325</sup> Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.

<sup>326</sup> Evidenca V.13.3 Plani vjetor Keshilli i Karrieres Alumni 2022-2023;. Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni.

|   |   |                             |                            |                             |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|   | numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen <sup>327</sup> .  |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Rezulton se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse, për vlerësim, dokumentimin dhe saktësimin e informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit <sup>328</sup> .   |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.   | Konstatojmë se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë si Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM; si dhe Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023 <sup>329</sup> . Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje <sup>330</sup> . |                             |                            |                             |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i>                                       |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e Përbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk Përbushet</b>  | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|   |   |                             |                            | <b>X</b>                    |

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>327</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 21 & 23

<sup>328</sup> Evidenca V.13.3 Plani vjetor Keshilli i Karrieres Alumni 2022-2023.

<sup>329</sup> Evidenca III.15.3 Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM.; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.  
; Evidencë 1.2 Plani strategjik FSHE.

<sup>330</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 21

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>  | <p>Konstatohet që studentët e UGJ-së janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës<sup>331</sup>, në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe në NJBSC<sup>332</sup> për vlerësimin e cilësisë së FESHSH.</p> <p>Rezulton se janë zhvilluar zgjedhjet për këshillat studentor në rang njësie kryesore dhe atë institucional<sup>333</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>                                  | <p>Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NJBSC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë<sup>334</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>Nga vizita në institucion, përgjatë takimin me studentët, konstatoam se ata janë të përfshirë në mënyrë indirekte, nëpërmjet realizimit të pyetësorëve për procesin mësimor në përmirësimin e cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor<sup>335</sup>.</p>                             |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësive/pedagogut përgjegjës.</p>                      | <p>Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</p> <p>Konstatohet që NJBSC zhvillon pyetësorë në mënyrë periodike dhe disponon instrumenteve matës që përdorin për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët<sup>336</sup>.</p>   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët e UGJ janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të</i></p>  |

<sup>331</sup> Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik.,

<sup>332</sup> Evidenca Tabela ASCAL BMAP, Tabela 24

<sup>333</sup> Evidenca 12 Statuti i Këshillit Studentor., Evidenca 13 Rregullorë e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor.

<sup>334</sup> Evidenca III.6 Procedura e ngritjes së grupit të punës dhe zhvillimi i pyetësorit.

<sup>335</sup> Evidenca Vendimi i NJBEMM për miratimin e RVB BMAP

<sup>336</sup> Evidenca III.6 Procedura e ngritjes së grupit të punës dhe zhvillimi i pyetësorit.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p><i>insitucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës</i></p> <p><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk Përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

| <b>Standardi V.6</b>   |   |
|--|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat UGJtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.   | Konstatohet se, institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore, Zyrës së It-së, si dhe Drejtorisë së Shërbimeve Universitare <sup>337</sup> , ku në bashkëpunim me Zyrën e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit vë në dispozicion të tyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do të ndjekin.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.  | Konstatohet që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UGJ-së dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Konstatohet se nëpërmjet Zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit si dhe lektorëve të departamenti, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rumbullakëta, aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon <sup>338</sup> . Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe në bashkërendim |

<sup>337</sup> Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA.

<sup>338</sup> Evidenca V.13.3 Plani vjetor Keshilli i Karrieres Alumni 2022-2023.; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | me NJBEMM orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale <sup>339</sup> .  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Konstatojmë që nëpërmjet Zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit ka nisur procesin e e gjurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit <sup>340</sup> .<br><br>Gjithashtu, konstatuam gjatë vizitës në institucion se, përgjegjësi dhe lektorët e departamentit të angazhuar në këtë programi studimi, mbajnë lidhje dhe gjurmojnë studentët pas diplomimit të tyre.   |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatojmë se nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon</i><br><br><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk Përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardeve të fushës V</b> | <b>Nuk Përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

## VI SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<sup>339</sup> Evidenca I.31 Marreveshjet institucionale per praktikat mesimore FESHSH.

<sup>340</sup> Evidenca II.18 Databazë Alumni.

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Universiteti i Gjirokastrës, ka hartuar Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies.<sup>341</sup> ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e syllabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet projektit TeComp dhe ICT në mësimdhënie janë përçuar ide inovative për metodat e reja të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë së edukimit përgjatë mësimdhënies.<sup>342</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>            | <p>Rezulton se, institucioni ka ngritur Sektorin e Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK), bazuar në Statutin e UGJ, Neni 94<sup>343</sup>.</p> <p>Gjithashtu në UGJ funksionon edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila harton politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për përmbushjen e standardeve kombëtare<sup>344</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>     | <p>Rezulton se, në UGJ, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre<sup>345</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, por edhe nga dokumentacioni i paraqitur nga institucioni, konstatoam se ai ka hartuar një instrument për matjen e procesit mësimor online, rezultatet e të cilit i shpërndahen fakulteteve<sup>346</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin</p>   | <p>Zyra e Njësimit të Brendshëm dhe Vlerësimit të Cilësisë është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve, për</p>  |

<sup>341</sup> Evidenca III.5.1 Miratimi i Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies.; Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies.

<sup>342</sup> Evidenca I.28 Raport projekti TeComp.; Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie.; Evidenca I.28.2; Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp).

<sup>343</sup> Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023..

<sup>344</sup> Evidenca VI.8.1 Vendim Senati Miratim i manualit të cilësisë.; Evidenca VI.8 Manuali i Cilësisë në UGJ.

<sup>345</sup> Evidenca III.6 Procedura e ngritjes së grupit të punës dhe zhvillimi i pyetësorit.

<sup>346</sup> Evidenca III.7 Analiza e pyetësorit dhe percjellja në fakultete.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.   | përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike <sup>347</sup> .<br>Gjithashtu, një strukturë tjetër e ngritur pranë UGJ-së është Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK), bazuar në Statutin e UGJ, Neni 94 <sup>348</sup> , i cili ka si detyrë të hartojë dhe të bëjë publike rezultatet e pyetësorit dhe të hartojë analizën SWOT për përmirësimin e procesit.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Rezulton se, institucioni nëpërmjet Analizës Vjetore dhe asaj kërkimore-shkencore të NJBEMM <sup>349</sup> , nxit departamentet të hartojë plan veprimin për marrjen e masave për përmirësimin e mësimdhënies.<br>Nga ana tjetër, rezulton se, pavarësisht se institucioni ka ngritur mekanizmat e duhur për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, nuk disponon instrumenta matës për vlerësimin e stafit akademik në mënyrë që të nxisë dhe të promovojë modelet e mira në shërbim të zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.<br><i>Rekomandojmë hartimin e paketës së instrumenteve matës për vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, të performancës së stafit akademik etj.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni ka ngritur Sektorin e Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK).<br/>Rezulton se, institucioni ka ngritur mekanizmat e duhur për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, por nuk disponon instrumenta matës për matjen e performancës së stafit akademik.<br/>Rekomandojmë hartimin e paketës së instrumenteve matës për vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, të performancës së stafit akademik etj.<br/>Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk Përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              | X                           |                              |

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<sup>347</sup> Evidenca VI.3 Rregullore e NJSBC.

<sup>348</sup> Evidenca 1 Statuti i UGJ.

<sup>349</sup> Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve   |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>  | <p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UGJ bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë si dhe në Statutin e UGJ-së, Neni 24<sup>350</sup>.</p> <p>Rezultoni se, institucioni ka ngritur Sektorin e Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK), bazuar në Statutin e UGJ, Neni 94<sup>351</sup>, si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila harton politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për përmbushjen e standardeve kombëtare<sup>352</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>               | <p>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë<sup>353</sup> zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm<sup>354</sup>.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet Manualit të Cilësisë<sup>355</sup>, që UGJ ka hartuar përcaktohen qartë strukturat kryesore përgjegjëse për zbatimin e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të</p> | <p>Rezultoni se institucioni nëpërmjet ngritjes së Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) monitor dhe vlerëson cilësinë e veprimtarisë mësimore dhe atë kërkimore shkencore.</p> <p>Nëpërmjet analizës së pyetësorit<sup>356</sup> dhe formularit të gjurmimit të studentëve<sup>357</sup>, konstatojmë që, institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për</p>  |

<sup>350</sup> Evidenca 1 Statuti i UGJ.

<sup>351</sup> Evidenca VI.6.2 Plan i vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.; Evidenca 1 Statuti i UGJ.

<sup>352</sup> Evidenca VI.8.1 Vendim Senati Miratim i manualit të cilësisë.; Evidenca VI.8 Manuali i Cilesise ne UGJ.

<sup>353</sup> Evidenca VI.8.1 Vendim Senati Miratim i manualit të cilësisë.; Evidenca VI.8 Manuali i Cilesise ne UGJ.

<sup>354</sup> Evidenca V.10.1 Miratim për ngritjen e GVB të programit të studimit BMAP; BMAP; MPMAS Evidenca V.10.2 Vendim senati Miratim GVB UGJ

<sup>355</sup> Evidenca VI.8 Manuali i Cilesise ne UGJ.

<sup>356</sup> Evidenca III.7 Analizae pyetesorit dhe percjellja ne fakultete.;

<sup>357</sup> Evidenca V.13 Formular gjurmimi i studenteve.



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.   | mësimdhënien online si dhe pyetësor për studentët e diplomuar në UGJ.<br>Gjithashtu rezultoi se, institucioni realizon përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton <sup>358</sup> .   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | Konstatohet që, institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes si dhe arritjeve përmes raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën mësimore-shkencore të stafit akademik <sup>359</sup> .  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</i><br><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk Përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të | Rezultoi se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike vlerësimit të brendshëm në rang fakulteti dhe departamenti, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve |

<sup>358</sup> Evidenca I.21.1 Plani i veprimit për Akreditimin Institucional periodik.

<sup>359</sup> Evidenca VI.4.2 Propozim për planin e zhvillimit të FESHSH 2021-2026.; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.

|  |  |
|--|--|
| <p>studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>të studimit që FESHSH dhe NJBEMM ofron,<sup>360</sup> metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë kërkimore shkencore duke analizuar faktorët e riskut për çdo kategori<sup>361</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>                 | <p>Nga shqyrtimi i Planit të Zhvillimit të UGJ<sup>362</sup>, Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH<sup>363</sup>, Plani Strategjik i Njesisë bazë EMM.<sup>364</sup>, si dhe Raportit të brendshëm të vlerësimit, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>  | <p>Rezulton se institucioni në kuadër të vlerësimit të mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies dhe Manualin e Cilësisë që garantojnë monitorimin dhe zhvillimin e cilësisë së programeve të studimit<sup>365</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër, konstatojmë se, institucioni duhet të zhvillojë metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e mësimdhënies.</p> <p>Sikurse evidentuam edhe në Standardin IV.1 duhet të hartojë paketën e instrumenteve matës për vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p> |

<sup>360</sup> Evidencë 6.2 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<sup>361</sup> Evidencë 1.16 Analiza e punës shkencore mësimore.

<sup>362</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë 2020-2025.

<sup>363</sup> Evidenca I.21.3 Plani i zhvillimit të NJBEMM dhe FESHSH 2021-2026.

<sup>364</sup> Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

<sup>365</sup> Evidenca VI.8 Manuali i Cilesise ne UGJ.

|   |  |                                     |                                    |                                     |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>   | <p>provimeve apo detyrave të studentëve apo/edhe vëzhgime në auditor.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e aNJBEMMinistrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> | <p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies online<sup>366</sup>;</li> <li>● Analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ<sup>367</sup>.</li> <li>● Analiza e punës mësimore dhe shkencore e FESHSH<sup>368</sup>;</li> <li>● Statistikë për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik NJBEMM<sup>369</sup>.</li> <li>● Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM<sup>370</sup>.</li> <li>● Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023<sup>371</sup>.</li> </ul> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpamëshme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike por institucioni duhet të zhvillojë metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e mësimdhënies.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk Përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |

<sup>366</sup> Evidenca III.7 Analizae pyetesorit dhe percjellja ne fakultete.

<sup>367</sup> Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ.

<sup>368</sup> Evidencë 3.10 Analiza e punës mësimore dhe shkencore e FSHE.

<sup>369</sup> Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.

<sup>370</sup> Evidenca III.15.3 Plani i aktiviteteve vjetore 2022-2023 NJBEMM.

<sup>371</sup> Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.

| <b>Standardi VI.4</b>  |  |
|--|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.                         | Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Strategjisë së Zhvillimit të UGJ-së si dhe Raportit veprimtarive akademike kërkimore shkencore të stafit akademik të UGJ-së, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit <sup>372</sup> .  |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton UGJtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.                                 | Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave <sup>373</sup> .   |
| <b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e aNJBEMMinistrative dhe studentëve e programit të studimit. | Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Statutin e UGJ-së <sup>374</sup> , në përcaktimin e anëtarëve të NJSBC <sup>375</sup> si dhe në ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm të këtij program studimi <sup>376</sup> . |

<sup>372</sup>Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë 2020-2025.; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.

<sup>373</sup>Evidenca III.6 Procedura e ngritjes së grupit të punës dhe zhvillimi i pyetesorit.

<sup>374</sup> Evidenca I Statuti i UGJ.

<sup>375</sup> Evidenca VI.3.1 Antarët e NJSBC UGJ.

<sup>376</sup> Evidenca V.10.1 Miratim për ngritjen e GVB të programit të studimit BMAF; BMAP; MPMAS

|  |  |                                     |                                    |                                     |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>  | <p>Bazuar në Statutin e UGJ-së, në Rregulloren e Studimeve, në kutotat e përcaktuara për studentët, në përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale dhe në grupet e vlerësimit, rezulton se, institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve<sup>377</sup>.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me institucionet arsimore për realizimin e praktikave profesionale, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus + luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij program studimi<sup>378</sup>.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk Përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|  |  |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në</p> | <p>Rezulton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të</p> |

<sup>377</sup> Evidenca I Statuti i UGJ.; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca V.10.1 Miratim për ngritjen e GVB të programit të studimit BMAF; BMAP; MPMAS

<sup>378</sup> Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ.; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ.; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ.

|   |   |
|---|---|
| <p>kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>   | <p>Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UGJ<sup>379</sup>.</p> <p>Gjithashtu, në shërbim të rritjes së cilësisë UGJ ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies. Nga ana tjetër, UGJ harton çdo akademik analizën SWOT të punës kërkimore-shkencore të institucionit<sup>380</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>      | <p>Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik të FESHSH-së<sup>381</sup>, të NJBEMM-së<sup>382</sup>, të programit të studimit, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>   | <p>Konstatojmë se, në Strategjinë zhvillimit<sup>383</sup> dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Rezulton, gjithashtu, se ne Planin Strategjik të FESHSH-së, të NJBEMM-së, të programit të studimit si dhe në analizën vjetore mësimore shkencore paraqitet një plan masash për përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara<sup>384</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Konstatojmë se, institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe analizën e tyre në department.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike</p>  | <p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, rezultoi se</p>   |

<sup>379</sup> Evidenca VI.8 Manuali i Cilesise ne UGJ.; Evidenca VI.2 Vendim Senati akademik për miratimin e programit të transparencës 2023 i rishikuar.

<sup>380</sup> Evidenca III.5 Udhezues mbi zhvillimin dhe perdorimin e metodave te mesimdhënies. Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.

<sup>381</sup> Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njesia Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore.

<sup>382</sup> Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

<sup>383</sup> Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025.; Evidenca 7 Strategjia e kerkimit shkencor në UGJ. Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023.

<sup>384</sup> Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njesia Kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore.; Evidenca I.8 Plani Strategjik e Njesise baze EMM.

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti <sup>385</sup> .  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk Përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|  |                       |                              |                             |                              |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e Përmbushjes së standardeve të fushës VI</b> | <b>Nuk Përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |                       |                              |                             | X                            |

<sup>385</sup> Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Arsim Parashkollor"

### **Pikat e forta dhe afirmime**

- Programi i studimit Ciklit të Parë, Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me aktet rregullatore në fuqi, dokumentet rregullatore të "Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër" dhe në përshtatje të plotë me fushën akademike të Fakultetit e Edukimit dhe të Shkencave Shoqërore, si dhe Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies.
- Programi i studimit ka një kurrikul të hartuar dhe të riorganizuar me kujdes për t'iu përgjigjur kërkesave dhe standardeve bashkëkohore në fushën e mësuesisë.
- Programi i studimit, është i hartuar për të përgatitur studentë në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.
- Staf i akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet nga ekspertë të fushës me një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie si dhe zotëron kualifikimet e duhura për zhvillimin me cilësi të tij.
- Ndërthurja e orëve në auditor me orët e praktikave profesionale në shkolla dhe angazhimi i studentëve në punën dhe kërkimin shkencor siguron një përgatitje profesionale dhe akademike të kënaqshme për studentët e mësuesisë.

### **Pika të dobëta**

- Mospërfshirja e literaturës së 5 viteve të fundit në një pjesë të syllabuseve lëndore të këtij program studimi (Standardi II.1 Kriteri 1).
- Mosmbështetja financiare e stafit akademik për publikime në revista ndërkombëtare (Standardi II Kriteri 6).
- Paraqitet një numër i vogël i botimeve të stafit akademik (Standardi II Kriteri 6).
- Pavaresisht se ka një staf të konsiderueshëm në numër, në njësinë baze janë një numër i vogël i personelit akademik me tituj dhe grada shkencore (Standardi IV.5.kriteri 1.)
- GVJ-ja konstaton se studimi i tregut nuk paraqet një qartësi. (Standardi I.3 kriteri 1.)

### **Rekomandime**

- GVJ-ja rekomandon përditësim të një pjesë të syllabuseve me literaturë të 5 viteve të fundit.
- GVJ-ja rekomandon përfshirjen e studentëve në kërkimet shkencore të Njesisë bazë sic mund të jenë edhe pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare.





### **Strengths and affirmations**


- The study program of the First Cycle, Bachelor in "Teacher for Pre School Education" has been drawn up by the Law on Higher Education and the regulatory acts in force, the regulatory documents of "Eqrem Çabej" University Gjirokastër and in full adaptation to the academic field of the Faculty of Education and Social Sciences, as well as the Department of Educational Sciences and Teaching Methodology
- The study program has a carefully designed and reorganised\ curriculum to respond to contemporary requirements and standards in the teaching field.
- The study program is designed to prepare students for the domestic and international market.
- The effective and contracted academic staff engaged in this study program consists of experts in the field with a long experience in teaching as well as possessing the appropriate qualifications for its quality development.
- Combining hours in the auditorium with hours of professional practices in schools and engaging students in work and scientific research ensures satisfactory professional and academic preparation for teaching students

### **Weaknesses**

- Not including the literature of the last 5 years in a part of the subject syllabi of this study program (Standard II.1 Criterion 1).
- Lack of financial support for academic staff for publications in international journals (Standard II Criterion 6).
- A small number of academic staff publications are presented (Standard II Criterion 6).
- Even though there is a considerable number of staff, there are a small number of academic personnel in the base unit with scientific titles and degrees (Standard IV.5.Criterion 1.)
- External Evaluation Group finds that the market study does not present clarity. (Standard I.3 Criterion 1.)

### **Recommendation**

- The External Evaluation Group recommends updating part of the syllabuses with literature from the last 5 years.
- External Evaluation Group recommends the involvement of students in the scientific research of the Basic Unit, as well as the participation in national and international scientific activities



**Shkalla e Përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUGJAT E VLERËSIMIT  | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                      |                     |                      |
|--|--|----------------------|---------------------|----------------------|
|  | Nuk përbushen                                  | Përbushen pjesërisht | Përbushen kryesisht | Përbushen plotësisht |
| <b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>   |  |                      |                     | X                    |
| <b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ANJBEMMINISTRI MI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>                          |  |                      |                     | X                    |
| <b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>  |  |                      |                     | X                    |
| <b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b> |  |                      |                     | X                    |
| <b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>  |  |                      |                     | X                    |
| <b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>  |  |                      |                     | X                    |
| <b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>   |  |                      |                     | X                    |